



SHSKUK
Shërbimi Spitalor dhe Klinik
Universitar i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospitaland University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)

Raport i Punës Janar-Dhjetor 2024

Prishtinë
Shkurt, 2025



Tabela e Shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BD	Bordi Drejtues
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Punës
QKMS	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTK	Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës
SP	Spitali i Përgjithshëm
QSHMSHIB	Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSKP	Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik
BQ	Barnatorja Qëndrore
BOR	Shfrytëzueshmëria e shtretërve (Një përqindje që tregon shfrytëzimin mesatar të shtretërve). Indikator i cili tregon efikasitetin dhe efektivitetin e shfrytëzimit të resurseve në dispozicion të njësisë spitalore.
ALOS	Kohëzgjatja e qëndrimit të pacientëve - Një mesatare e ditëve të qëndrimit të pacientëve në spitale. Indikator i cili e matë efikasitetin dhe efektivitetin së shërbimit shëndetësor të ofruar për pacient në njësinë spitalore.
Numri i vizitave ambulatorë	Numri i vizitave mjekësore që nuk kërkojnë shtrim në spital
Numri i Tomografive të Kompjuterizuara (CT)	Procedura të imazherisë të realizuara për diagnostikim
Rezonanca Magnetike (MRI)	Procedura të imazhërisë të realizuara për diagnostikim



Përmbajtja:

Hyrje.....	4
Përmbledhja Ekzekutive.....	5
1. Shërbimet shëndetësore të ofruara në SHSKUK.....	7
1.1. Shfrytëzueshmeria dhe Kohëzgjatja e Qëndrimit.....	8
1.2. Vizitat dhe Procedurat Diagnostikuese	8
1.3. Procedurat Kirurgjikale dhe Laboratorike.....	9
1.4. Shërbime të Specializuara	9
1.5. Shërbimet Obstetrike dhe Dializa	10
1.6. Statistika të Pacientëve.....	10
2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).....	12
2.1. Vizitat Ambulatore	14
2.2. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Kirurgjike në QKUK.....	15
2.3. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Internistike në QKUK.....	24
2.4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Diagnostike në QKUK.....	29
3. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK).....	32
4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Spitalet e Përgjithshme në SHSKUK.....	35
4.1. Efikasiteti i Shërbimeve	36
4.2. Cilësia e Shërbimeve	37
4.3. Shërbimet e ofruara sipas Spitaleve të Përgjithshme	39
5. Qendrat e shëndetit mendor me Shtëpi Integruese në Bashkesi dhe QIRSKP Shtime	59
6. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) Gjakovë.....	60
7. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive (QKMS).....	60
8. Menaxhimi Financiar në SHSKUK	61
9. Investimet Kapitale në SHSKUK.....	63
10. Donacionet	64
11. Shërbimet e reja dhe të konsoliduara	65
12. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues	66
Përfundim dhe Konkluzione.....	71
Anekset; Krahësimi i shërbimeve.....	72

Fjala Hyrëse:

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) përbën një nga institucionet publike më të mëdha dhe është ofruesi kryesor i shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Kosovës, me një rëndësi esenciale për sistemin shëndetësor të vendit. ShSKUK-ja, e cila përbëhet nga njësitë e saj përbërëse, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve cilësore e të sigurta për pacientët, përfshirë diagnostikimin, trajtimin, procedurat kirurgjikale, rehabilitimin dhe kujdesin parandalues.

Misioni ynë është të ofrojmë shërbime të sigurta, efektive dhe me kosto të arsyeshme, duke u mbështetur në standardet bashkëkohore të cilësisë. Ky përkushtim promovohet në vazhdimësi në të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK-së, me qëllim që shërbimet tona të reflektojnë nevojat reale të qytetarëve për kujdes shëndetësor cilësor dhe të qëndrueshëm.

Një nga sfidat kryesore në realizimin e këtij misioni ka qenë mungesa e të dhënave të standardizuara, me indikatorë kyç të performancës dhe të bazuara në evidenca nga njësitë përbërëse. Kjo mangësi ka kufizuar mundësinë për planifikime të sakta dhe për ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe burimeve njerëzore, duke u bazuar në kërkesat reale për shërbime shëndetësore.

Për të adresuar këto sfida, ky raport paraqet raportin e parë të standardizuar për të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK-së, i cili është ndërtuar mbi indikatorë kyç të performancës dhe synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të situatës aktuale, si dhe të jetë udhërrëfyes për zhvillimin e ardhshëm të institucionit. Duke u mbështetur në këtë qasje, ky raport synon të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e nevojave, sfidave dhe mangësive eventuale.

Kjo përpjekje për standardizimin e të dhënave dhe mbështetjen në evidenca në raport është vetëm fillimi i një procesi të vazhdueshëm, që do të përmirësohet dhe plotësohet me kohën, duke u përshtatur me dinamikat dhe sfidat që paraqiten. Ne besojmë se ky raport do të shërbejë si një dritare e re për të kuptuar gjendjen reale në institucion dhe si një mbështetje për vendimmarrje më të mirë dhe për shërbime më të sigurta, cilësore dhe kosto-efektive për qytetarët e Kosovës.

Me këtë, hapim një kapitull të ri në menaxhimin dhe zhvillimin e ShSKUK-së, duke siguruar që ky institucion të vazhdojë të luajë rolin e tij të përcaktuar me ligj dhe statut në mënyrën më efektive të mundshme.

Bordi Drejtues i ShSKUK-së



Përmbledhja Ekzekutive

Ky raport nënë të mujor për SHSKUK ofron një pasqyrë të plotë të aktiviteteve të realizuara, sfidat dhe arritjet me të cilat institucioni është përballur. Gjatë periudhës së vitit 2024, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka realizuar një volum të madh shërbimesh shëndetësore, duke përfshirë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe spitalet e përgjithshme në nivel vendi. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit ka qenë prioritet, me arritje të dukshme në disa indikatorë kryesorë:

Performanca dhe Efikasiteti

- ❖ **Shfrytëzimi i shtretërve (BOR):** Mesatarja e përgjithshme ishte **58%** në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK. Ndërsa, **44%** në spitalet e përgjithshme dhe **74%** në QKUK, duke treguar një përdorim efikas të kapaciteteve.
- ❖ **Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit (ALOS):** Pacientët kanë qëndruar mesatarisht **4.7 ditë**, me QKUK që ka një kohëzgjatje më të lartë prej **5.3 ditë** dhe 4.1 në spitalet e përgjithshme.

Shërbimet Shëndetësore

- ❖ **Vizita ambulatorë dhe specialistike:** Janë realizuar **1.88 milionë vizita**, ku QKUK kontribuon me **638 mijë vizita (33%)** dhe spitalet e përgjithshme me **1,1 milion vizita (58%)**, QSKUK me 67 mijë vizita (3%) dhe njësitë tjera me 3%.

Procedura diagnostikuese:

- ❖ Tomografi të Kompjuterizuar (CT): **54 764 ekzaminime**.
- ❖ Ultrazë: **214,552 ekzaminime**.
- ❖ Radiografi (RTG): **217 637 procedura**.
- ❖ Rezonancë Magnetike (MRI): **19 706 ekzaminime**
- ❖ Koronarografi: **4070 ekzaminime**

Kujdesi Obstetrik dhe Kirurgjia

- ❖ **Lindje:** Totali i lindjeve është **17,153**, nga të cilat **39%** janë realizuar me ndërhyrje cezariene (CS) apo **6078 lindje** me CS. **Fëmijë** të lindur janë 17,495 gjithsej në të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK.
- ❖ **Kirurgjia: Operacione:** **Totali i operacioneve është 44 485**, QKUK: 25,337(57%), Spitalet e Përgjithshme: **18,129(40%)** dhe QSKUK me **1019 (3%)**.

Kujdesi ndaj Cilësisë

- ❖ **Shkalla e vdekshmërisë:** E mbajtur në nivel të ulët, mesatarisht **2.% të pacientëve të shtrirë**.
- ❖ **Shërbimet intensive:** Njësia e mjekimit intensiv në QKUK ka pasur një shfrytëzim të lartë të kapaciteteve (**100%**) dhe një mesatare të ditëve të shërimit prej **14.7 ditë**, duke trajtuar raste kritike me përkushtim.
- ❖ **Investimet infrastrukturore,** kanë mundësuar insitucionet shëndetësore të ofrojnë shërbime të reja që më parë nuk ishin ofruar në institucionet publike shëndetësore.

Shërbimet e reja dhe konsoliduara



Fokusi në investimet strategjike të realizuara gjatë kësaj periudhe menaxhimi na ka mundësuar të ri aktivizojmë shërbimet shëndetësore dhe të ofrojmë shërbime shëndetësore të reja dhe në proces për pacientët e Republikës së Kosovës:

- ❖ Shërbimet për sulmin në tru (Stroke), shërbim i konsoliduar;
- ❖ Shërbimet e kardiologjisë invazive në Spital të Prizrenit (shërbim i ri);
- ❖ Shërbimet e MRI në Spital të Prizrenit (shërbim i ri);
- ❖ PET/CT në Klinikën Nukleare (Shërbim i ri);
- ❖ SPECT/CT në Klinikën Nukleare (Shërbim i ri);
- ❖ Ne process-Shërbimi i IVF, Klinika e Gjinekologjisë, shërbim i ri;
- ❖ Laboratori per screening neonatal;
- ❖ Laboratori i patologjisë per mutacionatet gjenetike;
- ❖ Toksikologjia-pergaditjet e fundit per fillim te punes;
- ❖ Sistemi i pozicionimit ne Onkologji-Radioterapia stereotaktike;
- ❖ Aplikimi i metodave te avansuara endoskopike ne Kliniken e Kardiokirurgjise;
- ❖ ESËL- Urologji (trajtimi i gureve ne veshka), renovim i tersishe i hapesires dhe zhvendosje e aparatures (shërbim i ri aktivizuar);
- ❖ Transporti Neonatal;
- ❖ Laboratori Citogjenetik;
- ❖ Shërbimet Endovaskulare;
- ❖ Shërbimet me navigator dhe mikroskop Neurkirurgjik;
- ❖ Shtime te kapaciteteve në shërbimet aktuale imazherike dhe diagnostike;
- ❖ Shërbimi spitalor me shtretër në Psikatrinë e Fëmijeve dhe adoloshenteve;
- ❖ Shërbimet e VATS ne Kliniken e Kirurgjise Torakale (Shërbim i konsoliduar).

Sfidat

- ❖ **Furnizimi farmaceutik:** Pavarësisht përmirësimeve në furnizime dhe donacione, sfidat në prokurim dhe zinxhirët e furnizimit mbeten një çështje për t'u adresuar.
- ❖ **Digjitalizimi** i shërbimeve shëndetësore.
- ❖ **Investimet infrastrukture:**
- ❖ **Trajnime dhe zhvillim i personelit:** Përdorimi më efektiv i burimeve ekzistuese dhe avancimi i aftësive profesionale.
- ❖ **Legjislacioni aktual në fuci.**

Përfundim

Raporti thekson progresin e konsiderueshëm të SHSKUK-së në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Republikës së Kosovës. Megjithatë rezultatet tregojnë përkushtim dhe përmirësim të vazhdueshëm, ka ende hapësira për optimizim në efikasitet, furnizim dhe teknologji. Angazhimi i drejtorisë do të vazhdojë në këtë drejtim për të siguruar që shërbimet shëndetësore të ofrohen në nivelin më të lartë të mundshëm, duke u përshtatur nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të vendit.

Elvir Azizi
Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK

1. Shërbimet shëndetësore të ofruara në SHSKUK

Shërbimet shëndetësore që ofrohen në SHSKUK janë të shumëllojshme dhe të orientuara për të ofruar kujdes të plotë dhe të specilizuar për pacientët duke filluar nga diagnostifikimi, trajtimi dhe deri te rehabilitimi.


Shërbimet Shëndetësore për periudhën janar-dhjetor 2024 përmbajnë treguesit kyç të performancës për shërbimet e ofruara në institucione të ndryshme shëndetësore të Kosovës, përfshirë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe spitalet e tjera të përgjithshme dhe njësitë tjera përbërëse të ShSKUK. Disa nga treguesit kryesorë përfshijnë:

Shërbimet e ofruara në SHSKUK								
Indikatoret kyç te performancës	QKUK	Spitalet e pergjiths hme	QSKUK	QKMS	QKMP Gjakove	QSHMBI	QIRSKP- Shtime	Gjithsej
BOR (shfrytëzueshmëria e shtretëve)	74%	44%					98%	58%
ALOS (kohëzgjatja e qëndrimit të pacientit/ës në spital)	5.3	4.1						4.73
Vizita ambulantore	638600	1100205	67073	21962	32281	28453	1269	1889843
Tomografi e Kompjuterizuar (CT-ja)	28827	25937						54764
Mamografi	2148	3949						6097
Ultrazë (numri total i ofruar ne te gjitha repartet)	90874	123387			291			214552
EKG (numri total i ofruar ne te gjitha repartet)	33378	114043						147421
Elektroencefalografia (EMNG-ja)	2604	184						2788
Electroencefalografia (EEG-ja)	5274	1284						6558
Operacione (numri total i ofruar ne te gjitha repartet)	25337	18129	1019					44485
Rentegen (RTG-ja)	85118	116200	11678		4641			217637
Rezonanca Magnetike (MRI)	15579	4127						19706
Laborator (Parametrat laboratorik)	2109689	2863981			104537			5078207
Ekokardiografi	7753	11247						19000
Stress Test (tredmil)	1050	1662						2712
Holter kardiak	984	417						1401
Koronarografi	3759	311						4070
Stentime	3732	120						3852
Femijet e lindur	7901	9594						17495
Numri i lindjeve	7648	9505						17153
Lindjet me CS	3121	3587						6708
% e lindjeve me CS	41%	38%						39%
Dializa	36478	83050						119528
Numri i pacienteve te shtrire	86458	76023					61	162542
Ditet e sherimit	453945	314259					21960	790164
Nr i vdekjeve	1682	1497						3179
% e te vdekurve ne raport me numrin e te shtrireve	2%	2%						2%
Aktivitete tjera						109741	1405	111146

Nga të dhënat analitike të tabelës për periudhën janar-dhjetor 2024, kemi një pasqyrë për treguesit kyç të performancës për QKUK dhe spitalet e tjera të Kosovës në të cilë shihet rezultate të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientet e Republikës së Kosovës.

1.1. Shfrytëzueshmëria dhe Kohëzgjatja e Qëndrimit në njësitë përbërëse të SHSKUK

- **Shfrytëzueshmëria e shtretërve (BOR):** Mesatarisht, shfrytëzimi i shtretërve në SHSKUK është **58%**, me QKUK që ka një normë më të lartë prej 74% dhe spitalet e përgjithshme 44%.
- **Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital (ALOS):** Pacientët qëndrojnë mesatarisht **4.7** ditë në SHSKUK, me QKUK që ka kohëzgjatjen më të lartë prej **5.3** ditë dhe **4.1** ditë mesatarisht.




1.2. Vizitat dhe Procedurat Diagnostikuese

- **Vizitat Ambulatorore dhe specialistike ne 24 ore pune:** Totali i vizitave në SHSKUK është **1,889.843**. QKUK me 638,600 vizita (33%) dhe spitalet e përgjithshme që kontribuojnë me 1.100.205 vizita (58%), **QSKUK:** 67.073 vizita (3.5%), **QKMS:** 21.962 vizita (1%), **QKMP Gjakovë:** 32.281 vizita (1%), **QSHMB:** 28.453 vizita (1%), **QIRSKP-Shtime:** 1269 vizita (0.1%).
- **Tomografi e Kompjuterizuar (CT):** Janë kryer gjithsej **54,764** skanime CT, **QKUK:** 28,827 (52.6%), **Spitalet e Përgjithshme:** 25,937 (47.4%).
- **Mamografi:** Totali i mamografive është 6,097, **QKUK:** 2,148 (35%), **Spitalet e Përgjithshme:** 3949 (65%).
- **Ultrazë:** **214,552** ultrazë janë kryer në total, **QKUK:** 90,874 (43%), **Spitalet e Përgjithshme:** 123,387 (57%).
- **EKG (Elektrokardiogramë):** Janë kryer 147,421 EKG, **QKUK:** 33,378 (23%), **Spitalet e Përgjithshme:** 114,043 (77%).
- **EMNG (Elektromiografi):** Totali i EMNG është 2,788, **QKUK:** 2604 (94%), **Spitalet e Përgjithshme:** 184 (6%).
- **EEG (Elektroencefalografi):** Janë kryer 6,558 EEG, **QKUK:** 5274 (79%), **Spitalet e Përgjithshme:** 1,284 (19%).

1.3. Procedurat Kirurgjikale, Diagnostike dhe Laboratorike

- **Operacione:** Totali i operacioneve është 44,485, **QKUK:** 25,337 (56%), **Spitalet e Përgjithshme:** 18,129 (41%) dhe **QSKUK me 1019 (3%).**




- **Radiografi (RTG):** Janë kryer 217 637 radiografi, **QKUK:** 85,118 (39%), **Spitalet e Përgjithshme:** 116 200 (55%), **QSKUK:** 11 678 (4%) dhe **QKMP Gjakove:** 4,641 (1%).
- **Rezonanca Magnetike (MRI):** Totali i MRI është **19 706**, **QKUK:** 15,579 (80%), **Spitalet e Përgjithshme:** 4,127 (20%).
- **Analiza Laboratorike:** 5,078,207 parametra laboratorik janë kryer në total, **QKUK:** 2,109,689 (41%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 2,863,981 (59%) parametra laboratorik.

1.4. Shërbime të Specializuara

- **Ekokardiografi:** Janë kryer 19,000 ekokardiografi, **QKUK:** 3759 (40%), **Spitalet e Përgjithshme:** 11,247 (60%).
- **Testet e Stresit (Tredmil):** Totali i testeve të stresit është 2,712, **QKUK:** 1050 (47%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 1,662 (53%).
- **Holter Kardiak:** Janë kryer 1401 holterë kardiakë, **QKUK:** 984 (70%), **Spitalet e Përgjithshme:** 417 (30%).
- **Koronarografi:** Totali i koronarografive është 4070, **QKUK:** 3759 (93%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 311 (7%).
- **Stent:** Totali i stenteave të vendosura në SHSKUK është 3852. **QKUK:** 3,732 (97%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 120 (3%).


1.5. Shërbimet Obstetrike dhe Dializa

- **Fëmijët e Lindur:** Totali i fëmijëve të lindur është 17,495, **QKUK:** 7,901 (45.0%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 9594 (55.0%).
- **Numri i Lindjeve:** 17,153 lindje gjithsej. **QKUK:** 7,648 (45%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 9,505 (55%).
- **Lindjet me CS (Cesarean Section):** Totali i lindjeve me CS është 6,708, me një përqindje të përgjithshme prej 39%. **QKUK:** 3 121 (41% e fëmijëve të lindur) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 3,587 (38% e fëmijëve të lindur).
- **Dializa:** Janë kryer 119,528 seanca dialize, **QKUK:** 36,478 (30%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 83,050 (70%).



1.6. Statistika të Pacientëve

- **Numri i Pacientëve të Shtrirë:** 162,542 pacientë të shtrirë. **QKUK:** 86,458 (53%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 76,023 (47%).
- **Ditët e Shërimit:** Janë regjistruar gjithsej 790 164 ditë shërimi. **QKUK:** 453,945 (59%) dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 314,259 (41%).
- **Numri i Vdekjeve:** Totali i vdekjeve është 3,179, me një përqindje të përgjithshme prej 2%. **QKUK:** 1,682 dhe 2% e pacientëve të shtrirë dhe **Spitalet e Përgjithshme:** 1,497 apo 2% e pacientëve të shtrirë.



2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK)

QKUK, ofron shërbime të zakonshme shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të shërbimeve publike shëndetësore në Republikën e Kosovës. Këto shërbime shëndetësore ofrohen nga 38 njësi të ndara në klinika dhe shërbime.

Tabela e më poshtme do të shfaq përmbledhjen e shërbimeve shëndetësore të ofruara në 38 njësi të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës.


N r	Njësitë e QKUK	Shfr i kapaciteve	Sherimi	Nr. të shtrirëve	Ditë shërimi	Nr.të operuarve	Vizita ambulatorore dhe specialiste	Shërbi me diagnostike	Shërbime radiologjike	Shërbime laboratorike	Shërbime tjera	Nr i vdekjeve	% vdekjeve
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	65%	2.4	27,594	66,707	4,021	8,361	44,495			69,643	0	-
2	Klinika e Dermatovenerologjisë	71%	7.3	1,073	7,806		22,952	1,505			11,987	0	-
3	Klinika e Kirurgjisë Abdominale	68%	5.5	2,985	16,339	2,787	14,885	4,607			1,591	67	2%
4	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	69%	7.4	713	5,287	1,102	3,611				2,173	0	0%
5	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	44%	7.7	2 361	18 102	2 172	29,707	884			7,201	8	0%
6	Klinika e Kirurgjisë Torakale	77%	7.1	944	6,749	746	3,942	275			1,012	8	1%
7	Klinika e Gastroenterologjisë	86%	10.1	1,022	10,352		8,225	5,782			8,755	58	6%
8	Klinika e Hematologjisë	80%	8.6	679	5,848		5,259	840			8,471	55	8%
9	Klinika e Neonotalogjisë	61%	3.7	8,360	31,284		3,497	1,795				129	2%
10	Klinika Infektive	69%	10.4	2,931	30,584		19,021	1,403				186	6%
11	Klinika e Syve	96%	4.9	4,152	20,395	4,697	45,214	7,688				0	0%
12	Klinika e Nefrologjisë	100%	7.0	944	6,584		9,172	3,760			43,058	78	8%
13	Klinika e Pulmologjisë	96%	12.9	1,797	23,202		16,100	7,786			760	143	8%
14	Klinika e Kardiologjisë	99%	3.7	7,251	27,102		18,705	34,043			5,184	278	4%
15	Klinika e Pediatrisë	91%	6.5	7,734	49,888		62,686	9,211			5,449	65	1%
16	Klinika e Endokrinologjisë	62%	8.9	811	7,233		15,937	6,445			27,140	3	0%
17	Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv	81%	14.7	628	9,203		129,808				19,982	302	48%
18	Klinika e ORL-së	77%	10.7	1,690	18,036	1,588	28,236	4,098			7,017	6	0%
19	Klinika e Neurologjisë	84%	8.1	1,858	14,975		18,215	8,810			5,566	238	13%
20	Klinika e Biokimisë Mjekësore									2,072,911			
21	Shërbimi Klinik Emergjent						22,492					0	
22	Klinika e Mjekesisë Fizikale dhe Rehabilitim	65%	15.3	390	5,949		12,522	439			53,090	0	0%
23	Klinika e Kirurgjisë Plastike	88%	8.1	831	6,757	2,243	9,457				12,659	3	0%
24	Klinika e Neurokirurgjisë	86%	7.3	1,030	7,524	848	4,595	1,246			3,297	4	0%

25	Klinika e Urologjisë	94%	3.4	1,430	4,792	2,128	15,165	835				3	0%
26	Klinika e Onkologjisë	79%	5.2	618	3190		55,330	405			3,033	0	
27	Klinika e Kardiokirurgjisë	78%	12.8	377	4,835	372	1,458	5,726			3,559	26	7%
28	Klinika e Psikiatrisë	54%	21.4	575	12,317		15 182	2 653			2 296	0	0%
29	Klinika e Radiologjisë								120,545				
30	Klinika e Reumatologjisë	91%	8.2	1,015	8,284		9,492	2,453			1,649	1	0%
31	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	54%	2.1	1,906	4,177	1,395	10,084	1,860				0	0%
32	Klinika Kirurgji Vaskulare	71%	4.1	1,522	6,177	1,238	8,416	2,140			3,706	21	1%
33	Klinika e Alergologjisë me Imunologji	61%	4.1	437	1,772		7,391	1,199			58	0	0%
34	Instituti i Psikiatrisë Forenzike	86%	24.5	461	11,287		647	408			1,259	0	0%
35	Institutet Paraklinike						626	22,247				0	
36	Shërbimi i Mjekësisë Nukleare						580	8,497				0	
37	Shërbimi i Mikrobiologjisë Klinike									36,778		0	
38	Shërbimi i Ortoproetikës						1630				1,775	0	
	Total	74%	5.3	86,458	453,945	25,337	638,600	193,535	120,545	2,109,689	311 370	1682	2%

Kapacitetet e Shfrytëzuara dhe Ditët e Shërimit, Mesatarja e shfrytëzueshmërisë: 74% dhe Mesatarja e ditëve të shërimit: 5.3 ditë

2.1. Vizitat Ambulatore

Klinikat me Vizitat më të Shumta Ambulatore dhe specialistike: Total i vizitave ambulatore dhe vizitave specialistike në klinika të QKUK-së është 638,600 vizita gjithsej:





- Klinika e Pediatrisë është shumë e frekuentuar për vizitat ambulantore dhe specialistike gjatë 24 oreve pune (62,686), duke treguar për një ngarkesë të lartë të pacientëve fëmijë dhe nevojën për shërbime pediatrike të specializuara.
- Klinika e Syve gjithashtu ka një numër të lartë të vizitave ambulantore (45,214), që tregon për një kërkesë të madhe për kujdes oftalmologjik të avansuar i cili ofrohet në QKUK.
- Klinika e Ortopedisë ka ofruar një numër prej 29,707 vizitave ambulantore në total, e cila tregon kërkesë shumë të madhe për këto shërbime nga qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe në bazë të fushës së specializuar të kësaj klinike.

Këto ngarkesa paraqesin sfidë të vazhdueshme për stafin mjekësor si dhe mbingarkesë të stafit për të ofruar shërbime të avansuara të nivelit terciar për qytetarët në nevojë.

Cilësia e Shërbimeve

Numri i Vdekjeve dhe Përqindja e Vdekshmërisë

- **Total i vdekjeve:** 1,682:
- **Përqindja e mesatare e vdekshmërisë:** 2%

Klinika me përqindjen më të lartë të vdekshmërisë: **Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv** me 31%.¹

Klinikë të cilat nuk kanë raportuar raste të vdekjes janë: Klinika e Syve, Dermatovenerologjisë, Kirurgjisë Maksillofaciale, Gjinekologjisë, Klinika e MKFR, Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve, Klinika e Psikaitrisë, Klinika e Alergologjisë dhe Psikiatria Forenzike.

2.2. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinikat Kirurgjike në QKUK

Efikasiteti dhe Cilësia e Shërbimeve të Klinikat Kirurgjike

Nr	Njësia Kirurgjike në QKUK	Shfr i kapaciteteve	Sherimi
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	65%	2.42
2	Klinika e Kirurgjisë Abdominale	68%	5.47
3	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	69%	7.42
4	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	44%	7.67
5	Klinika e Kirurgjisë Torakale	77%	7.15
6	Klinika e Syve	96%	4.91
7	Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv	81%	14.65
8	Klinika e ORL-së	77%	10.67
9	Klinika e Kirurgjisë Plastike	88%	8.13
10	Klinika e Neurokirurgjisë	86%	7.30
11	Klinika e Urologjisë	94%	3.35
12	Klinika e Kardiokirurgjisë	78%	12.82
13	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	57%	2.06
14	Klinika Kirurgji Vaskulare	71%	4.06

¹ Të dhënat nga mjekimi intenziv qendror (përgjithshëm) dhe mjekimi intenziv kirurgjik.

Shfrytëzimi i lartë i kapaciteteve: Klinikat e Syve (96%) dhe Kirurgjisë e Urologjisë (94%) tregojnë një shfrytëzim shumë të mirë të resurseve të tyre, duke sugjeruar një menaxhim efikas të kapaciteteve.

Kohëzgjatja e shkurtër e trajtimit: Klinikat si ajo Obstetrike Gjinekologjike (2.4 ditë) dhe e Kirurgjisë së Fëmijëve (2.06 ditë) kanë një kohëzgjatje të trajtimit relativisht të shkurtër, duke treguar efikasitet në shërbim dhe kthim të shpejtë të pacientëve.

Klinika e Kardiokirurgjisë ka mesataren më të lartë të ditëve të shërimit (12.82 ditë), që tregon për kohëzgjatjen e gjatë të trajtimit të pacientëve në këtë klinikë, për shkak të natyrës së trajtimit të këtyre pacientëve.

Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve ka një mesatare të ulët të ditëve të shërimit (2.06 ditë), që tregon për efikasitetin në trajtimin e pacientëve të rinj dhe rikuperimin e shpejtë të tyre.

Efikasiteti i Operacioneve Kirurgjike: Total numri i operacioneve: **25,337**.

Nr	Njësia Kirurgjike në QKUK	Nr i të operuarve
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	4021
2	Klinika e Kirurgjisë Abdominale	2787
3	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	1102
4	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	2172
5	Klinika e Kirurgjisë Torakale	746
6	Klinika e Syve	4697
7	Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv	0
8	Klinika e ORL-së	1588
9	Klinika e Kirurgjisë Plastike	2243
10	Klinika e Neurokirurgjisë	848
11	Klinika e Urologjisë	2128
12	Klinika e Kardiokirurgjisë	372
13	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	1395
14	Klinika Kirurgji Vaskulare	1238
	Gjithsej	25,337

Numri i Operacioneve: Klinika e Syve dhe Klinika Obstetrike Gjinekologjike kryesojnë për numrin më të madh të operacioneve, që tregon për një ngarkesë të lartë kirurgjikale në këto klinika.

Klinika e Syve ka realizuar gjithsej 4,697 operime të ndryshme.

Klinika Obstetrike Gjinekologjike ka kryer një numër të madh operimesh (4,021), ku 3121 operime ishin lindje me CS dhe 900 operime ishin te fushës specialisike duke treguar për një kapacitet të lartë operativ dhe shërbime komplekse kirurgjikale të ofruara.

Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale, megjithëse ka një kapacitet relativisht më të vogël (21 shtretër), ka një numër të konsiderueshëm të operacioneve (1 102), që tregon efikasitet të lartë në ofrimin e shërbimeve kirurgjikale.

Klinika Emërgjente

Klinika Emërgjente e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka treguar performancë të lartë gjatë periudhës Janar-dhjetor 2024, me një fluks të konsiderueshëm pacientësh dhe angazhim të fuqishëm të burimeve njerëzore.

Lloji i Shërbimit	Numri Vjetor	Mesatarja Ditore (≈365 ditë)
Vizita në reanimim	22,492	62
Vizita te pacientët internistikë	29,936	82
Vizita te pacientët kirurgjikë	15,436	42
Vizita te pacientët ortopedikë	20,673	57
Intervenime në sallën e vogël	7,757	21
Pacientë të operuar në S. Operative të Q. Emërgjente	1,275	3.5
Pranime në njësitë përkatëse nga Q. Emërgjente	9,796	27
Vizita mjekësore në Q. Emërgjente	96,294	263

Tabela paraqet analizën e shërbimeve të ofruara nga Klinika Emërgjente për periudhën Janar-Dhjetor 2024, bazuar në një total prej **365 ditësh operimi**.

- Klinika ka trajtuar një numër të lartë pacientësh, me një **mesatare prej 263 vizitash mjekësore ditore** në tërësi.
- Shërbimet më të shpeshta janë ato **internistike** (82 vizita ditore), të ndjekura nga ato **ortopedike** (57 vizita) dhe **kirurgjikale** (42 vizita).
- Shërbimet në reanimim mbajnë një peshë të rëndësishme, me **62 vizita ditore**, duke reflektuar rëndësinë e kujdesit intensiv.
- Intervenimet në sallën e vogël dhe operacionet në sallën operative kanë një numër mesatar ditor prej 21 apo gjithsej 7,757 nderhyrje dhe operime ne sallën operative ne te gjithë vitin ishihin realizuar 1,275 operime apo 3.5 operime ne dite te realiuzar ne kete salle, duke treguar fokusin në raste të caktuara.
- Për pranimet në njësitë përkatëse, ka pasur një mesatare prej **27 pacientësh në ditë**, çka tregon për një shkallë të konsiderueshme të referimit për trajtime më të avancuara dhe pune e madhe e cila realizohet cdo dite ne Klinikën Emërgjente të QKUK-së.

Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intenziv

INDIKATORI	VLERA TOTALE
MIQ, P. INTENSIV	
NUMRI TOTAL I SHITRETËRVE	25
NUMRI TOTAL I PACIENTËVE TË SHTRIRË	628
NUMRI I VDEKJEVE	277
DITË SHËRIMI TOTAL	9203 (44%)
MESATARJA E DITËVE TË SHËRIMIT	14.7 ditë
SHFRYTËZUESHMËRIA E KAPACITETEVE (MESATARE)	100%
MJEKIMIT INTENSIV KIRURGJIK (MIK)	



NUMRI TOTAL I SHTRETËRVE	Ndryshon nga 4 deri në 10 në varësi të muajit
NUMRI TOTAL I PACIENTËVE TË SHTRIRË	339
NUMRI I VDEKJEVE	25 (7%)
DITË SHËRIMI TOTAL	1208
MESATARJA E DITËVE TË SHËRIMIT	3.56 ditë
SHFRYTËZUESHMËRIA E KAPACITETEVE (MESATARE)	33%
GJYSEM-INTENSIV GJINEKOLOGJI (KOGJ)	
NUMRI TOTAL I SHTRETËRVE PËR TRAJTIM 24H	14
NUMRI TOTAL I PACIENTËVE TË SHTRIRË PËR TRAJTIM 24H	4079
DITË SHËRIMI TOTAL NË KOGJ	4181
MESATARJA E DITËVE TË SHËRIMIT NË KOGJ	1.02 ditë
SHFRYTËZUESHMËRIA E KAPACITETEVE (MESATARE) NË KOGJ	81.82%
TRAJTIMI PRE DHE POST OPERATIV	
NUMRI TOTAL I PACIENTËVE TË SHTRIRË PËR TRAJTIM PRE DHE POST OPERATIV	7443
NUMRI I ANESTEZIONEVE	19982
VIZITA SPECIALISTIKE	129808

Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv ka realizuar një punë të rëndësishme gjatë vitit 2024, duke ofruar kujdes intensiv dhe mbështetje për pacientët në gjendje kritike. Të dhënat e paraqitura reflektojnë aktivitetin dhe ngarkesën e klinikës, përfshirë kapacitetet e shfrytëzuara, ditët e trajtimit dhe numrin e pacientëve të shtruar.

1. Kapacitetet dhe Ngarkesa e Klinikës

- **Numri i shtretërve në Mjekimin Intensiv të Përgjithshëm (MIQ)** ka mbetur konstant në **25 shtretër**.
- **Numri i pacientëve të shtruar** gjatë vitit ishte **339**, me një shfrytëzim mesatar të kapaciteteve prej **100%**, duke treguar një mbingarkesë në disa periudha të vitit.
- **Dita mesatare e shërimit për pacientët në MIQ** ishte **14.7 ditë**, duke reflektuar kompleksitetin e rasteve të trajtuara.
- **Numri i pacientëve të ndërruar jetë në kuadër të MIQ** ishte **277**, duke treguar se klinika trajton raste me shkallë të lartë rrezikshmërie.

2. Njësia e Mjekimit Intensiv Kirurgjik (MIK)

- Kapaciteti i njësisë ishte **6 shtretër**, me **339 pacientë të shtruar** gjatë vitit.
- Shfrytëzueshmëria mesatare e kapaciteteve ishte **33.10%**, më e ulët në krahasim me MIQP.
- **Dita mesatare e shërimit** për pacientët në këtë njësi ishte **3.56 ditë**.
- **Numri i pacientëve të ndërruar jetë në këtë njësi** ishte më i vogël, vetëm **25 raste** gjatë vitit.

3. Shërbimi i Anestezisë

- **Numri total i anestezioneve** të kryera gjatë vitit ishte 19982, me një shpërndarje të barabartë përgjatë muajve.



- **Vizitat specialistike** për pacientët e trajtuar nga kjo klinikë arritën në **129,808** raste.

4. Shërbimet në Njësine e Gjinekologjisë-Intensive

- **Numri i shtretërve** për trajtimin intensiv të pacienteve gjinekologjike ishte **14**, me **4079** pacientë të shtruar gjatë vitit.
- **Dita mesatare e shërimit** në këtë njësi ishte **1.02 ditë**, duke treguar se shumica e rasteve menaxhohen shpejt dhe me sukses.
- **Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve** ishte **81.82%**, që sugjeron një përdorim efikas të burimeve.

Klinika e Kirurgjisë së Syve

Klinika e Syve ka zhvilluar një aktivitet të gjerë gjatë vitit 2024, duke trajtuar një numër të madh pacientësh dhe duke ofruar shërbime kirurgjikale, diagnostike dhe trajtime të specializuara. Të dhënat e mëposhtme reflektojnë performancën dhe ngarkesën e klinikës në të gjitha aspektet e shërbimeve të ofruara.

1. Kapacitetet dhe Shfrytëzimi i Klinikës

- **Numri i shtretërve** në klinikë ishte **58** përgjatë gjithë vitit.
- **Numri i pacientëve të shtruar** arriti në **4,152**, me një mesatare prej rreth **346** pacientë në muaj.
- **Ditët e shërimit** arritën në **20,395**, duke dhënë një mesatare prej **4.9 ditë qëndrimi për pacient**.

2. Shërbimet Kirurgjikale dhe Procedurat Mjekësore

- **Numri i operacioneve dhe procedurave kirurgjikale** ishte **4,589**, me një mesatare prej **383** operacione në muaj.
- **Operacionet për Katarakt (PHACO)** ishin **2,821**, duke përbërë pjesën më të madhe të ndërhyrjeve kirurgjikale.
- **Aplikimet intravitreale dhe intrakamerale të Anti-VEGF** për trajtimin e sëmundjeve të retinës arritën në **4,355** raste.
- **Ndërhyrjet për Glaukomë** arritën në **110** operacione.
- **Operacionet për Tumore të Syrit** ishin **63**, ndërsa operacionet për **Lëndime të Syve** ishin **73**.
- **Lista e pritjes** gjatë vitit ka qenë mesatarisht rreth **1,000** pacientë në muaj, duke treguar kërkesë të lartë për shërbime.

3. Shërbimet Ambulatore dhe Diagnostike

- **Vizitat ambulatore dhe konsultative** ishin **45,214**, duke reflektuar një ngarkesë të madhe të klinikës në trajtimin e pacientëve jo të shtruar.
- **Shërbimet diagnostike ECHO** ishin **950**, ndërsa **Tomografia Korneale** u realizua në **294** raste.



- **OCT (Tomografia e Koherencës Optike)**, një nga testet kryesore diagnostike, u realizua **4,998 herë** gjatë vitit.
- **Shërbimet laboratorike** ishin **986**, duke treguar për një përdorim relativisht të ulët krahasuar me vizitat dhe ndërhyrjet kirurgjikale.

4. Trajtimet Speciale dhe Raste të Referuara

- **Numri i rasteve të referuara për trajtim jashtë vendit** ishte **102**, duke treguar nevojën për trajtime të specializuara që nuk ofrohen ende në klinikë.
- **PPV - Vitrektomia** u realizua në **211 raste**, ndërsa **Cross-Linking për keratokonusin** u realizua **77 herë**.

Klinika ka treguar një efikasitet dhe cilësi të lartë të shërbimeve shëndetësore të ofruara, me një numër të lartë të pacientëve të trajtuar, procedurave të kryera dhe vizitave të realizuara. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe gjatësia e arsyeshme e shërimit janë tregues të një menaxhimi efektiv dhe ofrimit të kujdesit cilësor ndaj pacientëve.

Klinika e Kardiokirurgjisë:


Cilësia e Punës dhe Kujdesi ndaj Pacientëve

- **Parandalimi i Infeksioneve:** Janë marrë masa për të shmangur infeksionet intrahospitalore, përmes testimit të rregullt të sipërfaqeve në sallat operative dhe repartin e kujdesit intensiv.
- **Koha e Trajtimit dhe Ditët e Shërimit:** Janë kryer gjithsej 4835 ditë shërimi, duke u fokusuar te shërbimet e avancuara për trajtimin e rasteve komplekse të kardiokirurgjisë. Efikasiteti është rritur pas rinovimeve, duke e bërë më të lehtë për pacientët për të marrë kujdes në kohë.
- **Vdekshmëria:** Numri i vdekjeve gjatë kësaj periudhe ka qenë i kufizuar në 26 raste apo 7% e pacienteve të shtrire, që përfaqëson një përqindje të ulët, duke dëshmuar për përkushtimin dhe kujdesin e stafit mjekësor për trajtimin e rasteve të vështira.

Gjatë periudhës së raportuar, janë kryer gjithsej **372 ndërhyrje kirurgjikale kardiovaskulare**, të shpërndara në kategoritë e mëposhtme:

- **Urëzim aorto koronar – 245 raste** (65.86% e totalit), procedura më e zakonshme, e përdorur për të rikthyer qarkullimin e gjakut në arteriet e bllokuara.
- **Ndërrimi i valvulave – 46 raste** (12.37%), të ndara në:
 - ❖ **Ndërrimi i valvules aortale** – 24 raste
 - ❖ **Ndërrimi i valvules mitrale** – 20 raste
 - ❖ **Ndërrimi i valvules trikuspidale** – 2 raste
- **Defekte septale – 22 raste** (5.91%), që përfshijnë korrigjime në:
 - ❖ **Defektin e septumit ventrikular** – 10 raste
 - ❖ **Defektin e septumit atrial** – 12 raste
- **Ri operime – 21 raste** (5.65%), që sugjerojnë nevojën për ndërhyrje të mëtejshme pas operacionit fillestar.

- **Tjera – 38 raste (10.22%),** që mund të përfshijnë komplikacione ose ndërhyrje të ndryshme.



Ky grafik paraqet shpërndarjen e ndërhyrjeve kirurgjikale kardiovaskulare, ku vihet re se **urëzimi aorto koronar** është procedura më e shpeshtë. Në vijim janë ndërrimet e valvulave dhe ndërhyrjet për korrigjimin e defekteve septale.

Klinika e Kirurgjisë Abdominale:

Indikatorët Kryesorë të Punës

INDIKATORI	GJITHSEJ
NUMRI I SHITRETËRVE	66
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	2985
DITË SHËRIMI	16,339
NUMRI TOTAL I OPERACIONEVE	2787
INTERVENIME EMERGJENTE	884
INTERVENIME ELEKTIVE	1397
OPERACIONE LOKALE	506
VIZITA EMERGJENTE	9,481
VIZITA AMBULANTORE	5,404
NUMRI I VDEKJEVE	67

Efikasiteti i Shërbimeve

- **Mesatarja e ditëve të shërimit: 5.5 ditë**

- **Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve: 68%**
- **Mesatarja mujore e pacientëve të shtrirë: 249**

Numri i pacientëve dhe operacioneve

- Mesatarja mujore e pacientëve të shtrirë është 249, që tregon për një ngarkesë të qëndrueshme.
- Numri i lartë i operacioneve (2,787) dhe shërbimeve kirurgjikale tregon për një aktivitet të madh dhe efikas.
- Kombinimi i intervenimeve emergjente dhe elektive (884 emergjente dhe 1397 elektive) tregon për një balancim të mirë të trajtimit të rasteve urgjente dhe të planifikuara. që tregon për një kombinim të mirë të trajtimit të rasteve të emergjencës dhe atyre të planifikuara.
- Operacione lokale: 506.
- Numri i lartë i procedurave kirurgjikale dhe shërbimeve diagnostike tregon për një kapacitet të lartë të klinikës për të ofruar trajtime të avancuara dhe të specializuara për pacientët

Vizitat emergjente dhe ambulantore

- Numri total i vizitave emergjente është 9,481, që tregon për një veprimtari të madhe në trajtimin e rasteve urgjente.
- Numri total i vizitave ambulantore është 5,404, që tregon për një kërkesë të lartë për shërbimet ambulantore.

Klinika Obstetrike Gjinekologjike (KOGJ)

INDIKATORI	GJITHSEJ
NUMRI I SHITRETËRVE	280
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	27,594
DITË SHËRIMI	66,707
NUMRI TOTAL I OPERACIONEVE/SHËRBIMEVE	4,021
TOTALI I LINDJEVE	7,648
LINDJE ME S.C	3,121
DIAGNOSTIKË ECHO	38,223
CTG	43,772
VIZITA AMBULANTORE	8,361
TOTALI I FOSHNJËVE	7,955
MESHKUJ	4,023
FEMRA	3,878
GEMELLARE	212
TRI GEM	11
KATER GEM	1

Analiza e Efikasitetit dhe Cilësisë së Punës

1. Efikasiteti i Trajtimit

- **Mesatarja e ditëve të shërimit:** 2.4 ditë, një tregues i mirë për kohëzgjatjen e trajtimit dhe rikuperimit të pacientëve.
- **Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve:** 65%, që tregon për një përdorim efektiv të burimeve të disponueshme.
- **Numri i pacientëve të shtrirë:** 27,594 tregon për një ngarkesë të madhe dhe menaxhim të mirë të kapaciteteve.

2. Veprimtaritë Kryesore

- **Numri i lartë i operacioneve:** 4,021 dhe lindjeve me S.C: 3,121 tregon për një aktivitet të madh dhe një përkushtim ndaj shëndetit të nënave dhe foshnjëve.
- **Diagnostikë ECHO:** 38,223 dhe **CTG:** 43,722 tregon për një përdorim të gjerë të shërbimeve diagnostike.

Klinika ka treguar një efikasitet dhe cilësi të lartë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, duke trajtuar një numër të madh pacientësh dhe duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh diagnostike dhe kirurgjikale. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe koha mesatare e shërimit janë tregues të një menaxhimi efektiv dhe kujdesit cilësor ndaj pacientëve. Raporti i operacioneve për pacient është rreth 14.6%, duke treguar se shumica e pacientëve marrin trajtim konservativ.

Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve

Numri i Operacioneve

- Klinika ka realizuar gjithsej 1,395 operacione/shërbime, me 521 ndërhyrje emergjente dhe 874 elektive. Kjo tregon një kapacitet të lartë për të përballuar ndërhyrje kirurgjikale.

Analizë mbi Ndërhyrjet Kirurgjike Invazive (Operacionet Ditore)

Të dhënat e paraqitura përfshijnë ndërhyrje kirurgjike invazive të kryera mbi pacientët, të cilat janë realizuar dhe kanë mundur lirimin e pacientëve brenda ditës. Më poshtë është table e detajuar sipas llojit të procedurave dhe shpërndarjes së tyre:

LLOJI I NDËRHYRJES	NUMRI I RASTEVE	PJESËMARRJA (%)
HERNIA INGUINALIS	441	31.60%
RETENTIO TESTIS	710	50.87%
HYDROCOELLA TESTIS	94	6.71%
CYSTOSCOPY	121	8.66%
HERNIA UMBILICALIS	24	1.73%
PEG (PERCUTANEOUS GASTROSTOMY)	6	0.43%
GJITHSEJ	1395	

Pjesëmarrja e Operimeve Ditore Invazive: Operimet ditore invazive përbëjnë rreth 45.16% të totalit të operimeve të realizuara nga Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve (427 nga 1,395 operime gjithsej).

Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve ka treguar një përqendrim të lartë në kryerjen e operimeve ditore invazive, që janë efikase dhe reduktojnë nevojën për shtrimin në spital.

Vizita Ambulatore dhe Emergjente

- Totali prej 3,639 vizitave ambulatorë dhe 6,445 vizitave emergjente tregon për një përkushtim të madh ndaj kujdesit të pacientëve dhe diagnostikimit të hershëm.

Shërbimet Diagnostike

- Klinika ka realizuar 1,860 shërbime diagnostike përfshirë EHO, RTG dhe EKG, që janë të rëndësishme për diagnozën dhe trajtimin e saktë të pacientëve.

Ditë Shërimi dhe Shfrytëzimi i Kapaciteteve

- Numri total i ditëve të shërimit është 3,919 dhe kapaciteti i shtretërve është shfrytëzuar mesatarisht në 54%. Kjo tregon një menaxhim të mirë të burimeve dhe shërbimeve të ofruara.

2.3. Shërbimet shëndetësore të ofuara nga Klinikat Internistike në QKUK

Nr	Klinika	Shfrytëzimi i Kapaciteteve	Ditët e Shërimit	Vdekshmëria
1	Dermatovenerologji	71%	7.3	0%
2	Gastroenterologji	86%	10.1	6%
3	Hematologji	84%	8.6	8%
4	Neonatologji	61%	3.7	2%
5	Infektive	69%	10.2	6%
6	Nefrologji	100%	7.0	8%
7	Pulmologji	96%	12.9	8%
8	Kardiologji	99%	3.7	4%
9	Pediatri	91%	6.5	1%
10	Endokrinologji	62%	8.9	0%
11	Neurologji	84%	8.1	13%
12	Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim	65%	15.3	0%
13	Psikiatri	56%	21.5	0%
14	Psikiatri Forenzike	86%	24.5	0%
15	Reumatologji	91%	8.2	0%
16	Alergologji dhe Imunologji	61%	4.1	0%

Duke analizuar tabelën e të dhënave, identifikohen disa pika kyçe për efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara në këto klinika.

Shfrytëzimi i Kapaciteteve:

- Shumica e klinikave kanë një shfrytëzim të lartë të kapaciteteve. Klinika e Nefrologjisë ka një shfrytëzim mbi kapacitetin, në 100%, gjë që tregon mbingarkesë të kapacitetit të saj.
- Klinikat si ajo e Psikiatrisë dhe e Alergologjisë kanë shfrytëzim më të ulët (56% dhe 61%), duke sinjalizuar mundësi për riorganizim apo përdorim më të mirë të burimeve.

Mesatarja e Ditëve të Shërimit:

- Klinika e Psikiatrisë dhe Instituti i Psikiatrisë Forenzike kanë mesataren më të lartë të ditëve të shërimit, përkatësisht 21.5 dhe 24.5 ditë. Kjo është specifike për trajtime psikiatrike që kërkojnë kohë më të gjatë rehabilitimi.
- Klinika e Neonatologjisë ka një kohëzgjatje mesatare të shërimit prej 3.7 ditësh, e cila mund të jetë për shkak të natyrës së kujdesit të nevojshëm për të porsalindurit.

Vizitat Ambulatorike dhe Diagnostike:

- Klinika e Pediatriës dhe ajo e Kardiologjisë janë ndër klinikat më të ngarkuara me vizita ambulatorike dhe diagnostike, duke treguar një kërkesë të lartë për shërbime diagnostikuese.
- Klinika e Mjekësisë Fizikale dhe e Rehabilitimit ka një numër të lartë të vizitave diagnostike, që mund të jetë për shkak të natyrës së trajtimit rehabilitues.

Shkalla e Vdekshmërisë:

- Klinika e Neurologjisë ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë, 13%, duke reflektuar një shkallë të lartë të sëmundjeve në tru të avancuara tek pacientët që kërkojnë trajtim emergjent dhe intensiv.
- Klinika Infektive dhe ajo e Nefrologjisë, Hematologjisë dhe Pulmologjisë shkallen e vdekshmërie e kanë me nga 8% dhe Klinika Infektive me 6% që është për shkak të sëmundjeve të ndryshme.

Klinika e Kardiologjisë

INDIKATORI	VLERA TOTALE
EFIKASITETI I SHËRBIMEVE	
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË DHE DITËT E SHËRIMIT	
NUMRI TOTAL I PACIENTËVE TË SHTRIRË:	7,251
DITË SHËRIMI TOTALE:	27,102
MESATARJA E DITËVE TË SHËRIMIT	3.7 ditë
NUMRI TOTAL I SHTRITËRVE	75
VIZITAT AMBULANTORE DHE PROCEDURAT DIAGNOSTIKE	



VIZITA AMBULANTORE:	18,705
KORONAROGRAFI:	3,759
PCI (STENTE TË VENDOSUR):	3,732
PEJSMEKER TË PËRHERSHËM	114
PCI (STENT) PROCEDURA:	2,343
CRT:	10
ICD	31
EKOKARDIOGRAFI	7,753
ERGOMETRI:	1,855
TRANSEZOFAJEALE	381
EKG	19,505

Cilësia e Shërbimeve

1. Efektiviteti i Trajtit

- ❖ Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve: Shkalla mesatare e shfrytëzimit të kapaciteteve është e lartë (99%), që tregon se klinika po operon me efikasitet të plotë dhe ndoshta po përballon me mbingarkesë.
- ❖ Gjatësia e shërimit: Mesatarja e ditëve të shërimit është 3.7 ditë, që është një tregues i mirë për kohëzgjatjen e trajtimit të pacientëve.

2. Shërbimet Diagnostike dhe Procedurat e Specializuara

- ❖ Numri i lartë i vizitave ambulante dhe procedurave diagnostike: Tregon për një veprimtari të gjerë dhe një përkushtim ndaj diagnostikimit dhe trajtimit efektiv të pacientëve.

3. Kujdesi i Fizioterapisë dhe Shërbime të tjera Infrastrukturore

- ❖ Shërbimet e fizioterapisë: 301 shërbime të fizioterapisë tregojnë për një përkushtim ndaj rikuperimit dhe rehabilitimit të pacientëve pas trajtimeve mjekësore dhe kirurgjikale.

4. Menaxhimi i Rasteve Kritike

- ❖ Numri i vdekjeve: 278, që është një përqindje e vogël në krahasim me numrin total të pacientëve të shtrirë (7251). Kjo tregon për një menaxhim relativisht efektiv të rasteve kritike dhe një kujdes cilësor ndaj pacientëve.

Klinika e Neurologjisë

Përmbledhje Ekzekutive e Shërbimeve të Ofruara (Janar-dhjetor 2024)

INDIKATORI	GJITHSEJ
NUMRI I SHITRETRËVE	49
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	1,858
DITË SHËRIMI	14,975
TRAJTIMI I SULMIT NË TRU (I63)	870
SKLEROZA MULTIPLE (G35)	242
EPILEPSIA (G40)	2,240
MARRAMENDJE DHE JOSTABILITET (R42)	2,010
KOKEDHIMBJET (R51)	2,791
HIPERTENSIONI ARTERIAL PRIMAR (I10)	1,510
SPONDILLOZA (M54)	829
MIGRENA (G43)	307



VIZITA EMERGJENTE - KONSULTATIVE	5,614
VIZITA AMBULANTORE	12,601
DIAGNOSTIKË EEG	3,929
DIAGNOSTIKË EMNG	2,360
DIAGNOSTIKË DOPPLER UZ	2,521
KABINETI I SËMUNDJEVE DEMILINIZUSE	3,677
NEUROPSIKOLOGJIA	244
NEUROFIZIATRIA	329 (1,645 seanca)
GJATËSIA E SHËRIMIT	8.1 ditë
SHFRYTËZIMI I KAPACITETEVE (%)	84%
NR I VDEKJEVE	238

Efikasiteti i Trajtimimit

- **Mesatarja e ditëve të shërimit:** 8.1 ditë
- **Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve:** 84%
- **Numri i pacientëve të shtrirë:** 1,858 tregon për një ngarkesë të qëndrueshme dhe menaxhim të mirë të kapaciteteve.

Veprimtaritë Kryesore

- **Trajtimi i sulmit në tru (I63):** 870 raste dhe **Epilepsia (G40):** 2,240 raste tregojnë për një përkushtim të madh ndaj trajtimit të sëmundjeve neurologjike.
- **Vizita emergjente - konsultative:** 5,614 dhe **vizita ambulantore:** 12,601 tregojnë për një angazhim të madh në trajtimin e rasteve urgjente dhe ambulantore.

Kujdesi i Pacientëve dhe Menaxhimi i Rasteve

- **Numri i lartë i diagnostikave EEG (3,929) dhe EMNG (2,360)** tregon për një përdorim të gjerë të shërbimeve diagnostike dhe një përkushtim ndaj diagnostikimit të saktë të pacientëve.
- **Nr i vdekjeve:** 238 apo 13% të pacientëve të shtrirë tregon për një menaxhim të rasteve kritike dhe kujdes cilësor për pacientët.

Klinika ka treguar një efikasitet dhe cilësi të lartë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, duke trajtuar një numër të madh pacientësh dhe duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh diagnostike dhe trajtimi. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe koha mesatare e shërimit janë tregues të një menaxhimi efektiv dhe kujdesit cilësor ndaj pacientëve.

Klinika e Pediatrië

Përmbledhje Ekzekutive e Punës së Realizuar me Indikatorë Kyç të Performances (Janar-Dhjetor 2024)

INDIKATORI	GJITHSEJ
NUMRI I SHITRETËRVE	151
DITËT E MJEKIMIT	49,888



SHFRYTËZIMI I KAPACITETEVE (%)	91%
VIZITA AMBULANTORE SPECIALISTIKE	21,141
VIZITA E PRANIMIT KONTROLLA	41,545
PRANIMET (TE SHTRIRË)	7,734
LËSHIMET	7,755
EKG	1,312
EEG EKZAMINIM	1,345
ECHO E ZEMRËS	2,519
ECHO E ABDOMENIT	2,504
ECHO E TRURIT	545
ECHO E MUSHKËRIVE	645
EXITUS	65
GASTROSKOPI	1
SONDA NAZOGASTRIKE	621
INTUBIMET	92
KULTURË ASPIRATE	1,255

Indikatorët Kyç të Performancës

1. Efikasiteti i Shfrytëzimit të Kapaciteteve

- ❖ **Shfrytëzimi i kapaciteteve:** 91%, tregon një përdorim të mirë dhe efektiv të burimeve spitalore të disponueshme.

2. Efikasiteti i Trajtitit dhe Kujdesit të Pacientëve

- ❖ **Ditët e mjekimit:** 39,888 ditë, me një mesatare prej 6.5 ditësh për pacient.
- ❖ **Numri i pacientëve të pranuar:** 7,734 dhe **numri i lëshimeve:** 7,755, tregon për një rrotacion efikas të pacientëve në klinikë.

3. Diagnostika dhe Procedurat Shëndetësore

- ❖ **Vizitat ambulantore specialistike:** 21,141 dhe **vizitat e pranimit kontrolla:** 41,545 tregojnë për një përkushtim ndaj diagnostikimit dhe trajtimit.
- ❖ **EKG:** 1,312, **EEG:** 1,345, dhe **Echo e zemrës:** 2,519, tregojnë për një përdorim të gjerë të shërbimeve diagnostike cilësore.

4. Menaxhimi i Rasteve Kritike

- ❖ **Exitusat:** 65 apo 1%, tregon për menaxhimin e rasteve kritike dhe kujdes cilësor për pacientët.
- ❖ **Intubimet:** 92, dhe **kulturë aspirote:** 1,255, tregojnë për trajtime intensive dhe përkujdesje kritike.

Klinika ka treguar një efikasitet dhe cilësi të lartë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, duke trajtuar një numër të madh pacientësh dhe duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh diagnostike dhe trajtimi. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe koha mesatare e mjekimit janë tregues të një menaxhimi efektiv dhe kujdesit cilësor ndaj pacientëve. Optimizimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i shërbimeve diagnostike dhe trajtimit do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve.



Klinika e Gastroenterologjisë dhe Hepatologjisë:

Klinika e Gastroenterologjisë dhe Hepatologjisë me kapacitetet e veta profesionale dhe infrastrukture ka ofruar një game shërbimesh në funksion të diagnostifikimit dhe trajtimit të pacientëve të cilët lëngojnë nga problemet gastrohepatologjike.

Efikasiteti i Shërbimeve


1. **Kapacitetet:** Klinika operoi me 33 shtretër dhe një shkallë shfrytëzimi (BOR) prej **71.2%**, tregues i përdorimit efektiv të burimeve.
2. **Fluksi i pacientëve:**
 - ❖ **Pacientë të shtrirë:** 1022 raste dhe 10,352 dite shërimi.
 - ❖ **Gastroskopi:** 2,185 raste (1,033 diagnostike dhe 1,152 intervenive).
 - ❖ **Kolonoskopi:** 1,436 raste (780 diagnostike dhe 656 intervenive).

Cilësia e Shërbimeve

1. **Rezultatet klinike:** Norma e vdekshmërisë prej 6% është në përputhje me standardet për raste emergjente.
2. **Trajtimi i rasteve specifike:** Procedura si hemostaza endoskopike (229 raste) dhe largimi i trupave të huaj (81 raste) u realizuan me sukses.

2.4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Klinkat/shërbimet diagnostike në QKUK

Klinika e Radiologjisë:




Nga të dhënat e paraqitura, vërehet një numer i lartë i ekzaminimeve radiologjike dhe imazherike në QKUK gjatë periudhës janar-dhjetor 2024:



- **RTG (Radiografia) – 85,118 raste**
- **Ultraze (Ultrasonografia) – 25,380 raste**
- **CT (Tomografia e Kompjuterizuar) – 28,827 raste**
- **MRI (Rezonanca Magnetike) – 15,579 raste**
- **Mamografi – 2,148 raste**
- **Biopsitë dhe Procedurat Invazive**
 - ❖ Biopsia e gjirit (254 raste), biopsia me gjilpërë (753 raste) dhe biopsia nën udhëzimin e ultrazërit (313 raste) tregojnë se një pjesë e pacientëve kanë pasur nevojë për vlerësime më të thelluara për patologji të ndryshme.
- **Fluoroscopia dhe DSA (Digital Subtraction Angiography)**
 - ❖ Me 2,169 raste të fluoroskopisë dhe vetëm 68 raste të DSA, vihet re se përdorimi i metodave fluoroskopike është i kufizuar.
- **Angio CT – 1,605 raste**

Mjekësia Nukleare:




- **Totali i shërbimeve:** 7992 procedura diagnostike dhe trajtuese.

Shërbimet kryesore:

- **DEXA:** 4,335 ekzaminime.
- **Scintigrafia: e kockave:** 2233 raste, 427 raste te veshkeve, 447 raste te tiroides,
- **PET/CT:** 230 ekzaminime që nga qershori 2024.
- Fillimi i shërbimit PET/CT në sektorin publik, një hap i madh për diagnostikimin.

Shërbimi i Mikrobiologjisë Klinike dhe Klinikën e Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Njësia e Mikrobiologjisë ka ofruar një numër të madh analizash për pacientët, duke përfutur nga diagnostikimi i saktë dhe trajtimi i duhur. Rezultatet janë si më poshtë:



Rezultatet

Analizat Pozitive

- Totali prej 7,670 analizash pozitive tregon për pacientët të cilët janë diagnostikuar me infeksione ose sëmundje të tjera mikrobiologjike.
- Këto rezultate ndihmojnë në identifikimin e saktë të patogjenëve dhe në përshkrimin e trajtimit të duhur për pacientët.

Analizat Negative

- Totali prej 19,764 analizash negative tregon për pacientët që nuk janë diagnostikuar me sëmundje infektive gjatë këtyre testeve specifike.
- Këto rezultate janë të rëndësishme për të përjashtuar infeksionet dhe për të përcaktuar hapat e mëtejshëm të kujdesit.

Analiza Serologjike

- Totali prej 9,344 analizash serologjike ndihmon në zbulimin dhe monitorimin e përgjigjeve imune dhe infeksioneve virale.

- Këto analiza ofrojnë informacion të vlefshëm për gjendjen imune të pacientëve dhe për praninë e antittrupave kundër patogjenëve specifik

Cilësia dhe Efikasiteti i Shërbimeve

Njësia ka treguar një nivel të lartë të saktësisë në diagnostikimin e sëmundjeve infektive, duke ndihmuar në identifikimin e patogjenëve dhe në përshkrimin e trajtimit të duhur.

Klinika e Biokimisë e shpërndarë në njësitë përbërëse të QKUK ka ofruar një numër të lartë të testeve laboratorike, nga të cilat kanë përfituar pacientët në nevojë;

Efikasiteti i Punës

1. Numri i Pacientëve

- Klinika e Biokimisë ka trajtuar një total prej **745,847 pacientësh** gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

2. Numri i Analizave të Realizuara

- Totali prej **2,072,911 analizash të realizuara** është një tregues i qartë i nivelit të lartë të aktivitetit dhe efikasitetit të klinikës. Kjo përfshin një gamë të gjerë analizash biokimike që ndihmojnë në diagnostikimin dhe monitorimin e shëndetit të pacientëve.

Instituti i Patologjisë:

Pikat Kryesore

EMËRTIMI	TOTALI	MESATARJA DITORE
BIOPSI	13,046	49.41
CITOLOGJI	2,340	8.86
PAP TESTE SCREENING	2,007	7.6
PAP TESTE KOGJ	2,970	11.25
BIOPSI INTRAOPERATIVE	42	0.16
HISTOKIMI	36	0.16
IMUNOHISTOKIMI	1,455	5.51
SISH	25	0.09
AUTOPSI	5	0.02
TESTIME MOLEKULARE	321	1.22
KONSULTA NGA JASHTË	626	2.37

Instituti i Patologjisë ka treguar një efikasitet të lartë dhe cilësi në shërbimet diagnostike, me një gamë të gjerë analizash. Mesataret ditore për 264 dite pune në vit, na ofrojnë të dhënat e larteshënuara, ku mund të shihet se rreth 49.41 biopsi në ditë realizohen, 8.86 citologji, 7.6 pap teste screening, 11.25 pap teste Kogj.



Klinika e Onkologjisë:

	RASTET E REAJ	RASTET E BARTURA	GJITHSEJ	
GJIRI	473	875	1348	22%
MUSHKERIT	276	513	789	13%
GASTROINTESTINAL	474	897	1371	22%
UROGJENITAL TEK FEMRAT	297	589	886	15%
UROGJENITAL TEK MESHKUJT	297	528	794	13%
KOKE	77	160	237	4%
QAFE	79	152	231	4%
INDE TE BUTA, LEKURA,TE TJERA...	177	298	475	7%
GJITHESEJ	2119	4012	6131	

Kategoritë më të zakonshme

- Në të gjitha kategoritë, **65% e rasteve janë bartura**, ndërsa **35% janë raste të reja**, që gjithsej japin një numër të pacientëve me 6131 pacient që trajtohen me sëmundje malinje në Klinikën e Onkologjisë të QKUK-së.
- Gastrointestinale (1371 raste) me 22%** dhe **Gjiri (1348 raste) me 22%** përbëjnë grupet më të mëdha.
- Kokë (237 raste) dhe Qafë (231 raste)** janë kategoritë më të vogla në numër të përgjithshëm.
- Rastet e reja:** Totali prej 2,119 rasteve të reja tregon për një kapacitet të lartë për diagnostikimin e kancerit.
- Shpërndarja e rasteve sipas llojeve:** Gjiri (473 raste) dhe Gastrointestinal (474 raste) janë kategoritë me më shumë raste të reja, duke treguar për një përkushtim të madh ndaj këtyre llojeve të kancerit.



3. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK)

Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK) është një institucion kryesor mjekësor, arsimor dhe shkencor në fushën e stomatologjisë në Kosovë dhe është një institucion kyç në ofrimin e shërbimeve stomatologjike për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Klinika								
Nr i pacientëve	2456	2203	1174	1086	803	1340	4190	13252
Sherbimet								
Nr i vizitave	9330	8520	12969	4905	13117	10318	7914	67073
Ortopantomografi me analize	825	3557	1872	228	1241	58	2896	10677
RTG Retroalveolare me analize	261	305	11	19	227	1204	978	3005
3D dhe Telerentgen me analize	5	200	165	14	18	9		411
Aparate ortodontike mobile			197					197
Aparate ortodontike fikse			119					119
Zgjerues rapid i nofules			8					8
Implante dentare		10						10
Proteza mobile akrilati					1429			1429
Proteza mobile të skeletuara					317			317
Punime fikse protetikore					2352			2352
Rindërtime					128			128
Trajtime për fëmijët me nevoja të veçanta	279							279
Trajtimi me ndihmën e sedacionit inhalator	62							62
Mbushje amalgami	158					551		709
Mbushje kompoziti	3092				27	10193	5	13317
Mbushje endodontike	290					2093	1	2384
Nxjerrje e dhëmbëve	2572	6445					19	9036
Nxjerrje kirurgjike		532						532
Trajtim i alveolitit		15						15
Intervenime kirurgjike me laser				48				48
Intervenime kirurgjike me llambo				149				149
Intervenime kirurgjike mukogingivale		57		36				93
Intervenime kirurgjike të cistave nofulllore		56						56
Apikotomi		94						94
Intervenime kirurgjike të tumoreve të indeve të buta		32						32
Largim i depozitimeve të forta				6881				6881
Kiretazhë e xhepave parodontal				3182				3182
Gingivektomi me plastikë				24				24
Trajtim preventiv i dhëmbëve				1518				1518
Te tjera	24392	18166	13331	7281	30529	25626	4257	123582
Nr total i shërbimeve	41266	37989	28672	24285	49385	50052	16070	247719

Shërbimet Klinike:

- **Nr i pacientëve:**
 - ❖ Klinika e Pedodoncisë: 2,456 pacientë
 - ❖ Klinika e Kirurgjisë Orale: 2,203 pacientë
 - ❖ Klinika e Ortodoncisë: 1,174 pacientë
 - ❖ Klinika e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale: 1,086 pacientë
 - ❖ Klinika e Protezës Stomatologjike dhe Materialeve Dentare: 803 pacientë
 - ❖ Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit dhe Endodoncisë: 1,340 pacientë
 - ❖ Klinika e Tranzhit: 4,190 pacientë
 - ❖ **Nr total i pacientëve:** 13,252 pacientë
- **Nr i vizitave:**
 - ❖ Klinika e Pedodoncisë: 9,330 vizita
 - ❖ Klinika e Kirurgjisë Orale: 8,520 vizita
 - ❖ Klinika e Ortodoncisë: 12,969 vizita
 - ❖ Klinika e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale: 4,905 vizita
 - ❖ Klinika e Protezës Stomatologjike dhe Materialeve Dentare: 13,117 vizita
 - ❖ Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit dhe Endodoncisë: 10,318 vizita
 - ❖ Klinika e Tranzhit: 7,914 vizita
 - ❖ **Nr total i vizitave:** 67,073 vizita

Diagnostikimet:


- ❖ **Ortopantomografi me analiza:** 12,677 raste
- ❖ **RTG Retroalveolare me analiza:** 3,005 raste
- ❖ **3D dhe Telerentgen me analiza:** 608 raste

Shërbimet Ortodontike:

- ❖ **Aparate ortodontike mobile:** 197 raste
- ❖ **Aparate ortodontike fikse:** 119 raste


Ndërhyrjet kirurgjike:

Numri total i ndërhyrjeve Kirurgjike ishte 1019. Në Klinikën e Kirurgjisë Orale ishin ofruar 786 ndërhyrje Kirurgjike dhe 233 ndërhyrje kirurgjike janë ofruar në Klinikën e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale.



Shërbimet protetike dhe ortodontike:

Janë realizuar **4098 proteza** totale mobile dhe fikse, duke treguar një volum të konsiderueshëm të punimeve protetike. 3552 është numri i punimeve protetikore fikse, 1429 numri i protezave mobile akrilati dhe 317 proteza mobile te skeletuara.




Numri i punimeve fikse ortodontike të aplikuara (119):

Shërbim i ri i aktivizuar nga viti 2006/2007: Aktivizimi i këtij shërbimi është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e trajtimeve ortodontike në vend, duke ofruar një zgjidhje moderne për trajtimin e malokluzioneve dhe problemeve të tjera dentare.

Diagnostika:

- Realizimi i **11678 radiografive** me një mesatare ditore prej **53.08 (220 dite pune)** është një tjetër tregues i rëndësishëm i kapacitetit diagnostikues të qendrës.



Infrastruktura dhe kapaciteti: Shtimi i **11 njësive të reja** stomatologjike ka ndikuar pozitivisht në efikasitetin operacional të qendrës, duke mundësuar trajtimin e një numri të madh pacientësh brenda një periudhe të kufizuar.



4. Shërbimet shëndetësore të ofruara nga Spitalet e përgjithshme të SHSKUK

Shërbimet Shëndetësore në Spitalet e Përgjithshme të SHSKUK Janar-Dhjetor 2024								
Indikatoret e performancës	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Vushtrri	Prizren	Gjakovë	Ferizaj	Gjithsej
BOR (shfrytëzueshmëria e shtretëve)	42%	58%	43%	56%	42%	41%	68%	44%
ALOS (kohëzgjatja e qëndrimit të pacientit/ës në spital)	4.5	3.83	4.69	4	3.8	4.2	3.6	4.1
Vizita ambulantore	149504	217663	191082	54817	297684	99206	90249	1100205
Tomografi e Kompjuterizuar (CT-ja)	3917	3253	5959	1073	4271	4144	3320	25937
Mamografi	1043	544	1089	180	697	0	396	3949
Ultrazë (numri total i ofruar në të gjitha repartet)	24302	6185	28240	7032	20828	15989	20811	123387
EKG (numri total i ofruar në të gjitha repartet)	35553	6246	16109	10122	13795	15004	17214	114043
Elektroencefalografia (EEG-ja)	196	227	104	0	265	492	0	1284
Operacione (numri total i ofruar në të gjitha repartet)	2054	2871	3024	1173	4719	2412	1876	18129
Ri-operimet	4	0	0	5	10	0	2	21
% e rioperimeve	0%	0	0	0%	0%	0	0%	0
Rentegen nativ (RTG-ja)	16837	15560	26662	5217	24159	14355	13410	116200
Rezonanca Magnetike (MRI)	0	0	2622	0	1505	0	0	4127
Laborator (Parametrat laboratorik)	210136	128188	1146070	68279	654229	524670	132409	2863981
Ekokardiografi	1636	3160	2391	449	1626	898	1087	11247
Stress Test (tredmil)	0	327	930	215	190	0	0	1662
Holter kardiak	0	134	0	56	227	0	0	417
CT Angiograf	0	0	0	0	0	0	0	0
Fëmijet e lindur	1296	1603	1412	111	2416	1564	1192	9594
Numri i lindjeve	1288	1598	1390	111	2382	1549	1187	9505
Lindjet me CS	535	635	661	40	968	514	234	3587
% e lindjeve me CS	42%	40%	48%	36%	41%	33%	20%	38%
Dializa	6560	12056	13190	0	30172	9641	11431	83050
Numri i pacientëve të shtrirë	11015	10301	12975	3235	19274	14966	4257	76023
Ditët e shërimit	49384	39814	60858	12935	72685	63176	15407	314259
Nr i vdekjeve	246	138	353	36	408	254	62	1497
% e te vdekurve në raport me numrin e të shtrirëve	2%	1%	3%	1%	2%	2%	1%	2%
Koronarografi	0	0	0	0	311	0	0	311
Stent					120			

Tabela e lartë shënuar, përmbledh punën e realizuar në shtatë spitale të përgjithshme të cilat operojnë në Republikën e Kosovës dhe janë në kuadër të SHSKUK

4.1. Efikasiteti i Shërbimeve


1. Shfrytëzueshmëria e Shtretërve (BOR)

Mesatarja e përgjithshme e BOR është 44% në të gjitha njësitë spitalore.

Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj ka shfrytëzueshmërinë më të lartë, me 68%, duke sugjeruar një menaxhim intensiv të shtretërve, megjithëse numri i përgjithshëm i tyre është më i vogël.

Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri renditet i dyti me një BOR prej 56%, duke reflektuar një menaxhim efikas për një numër të kufizuar shtretërish.

Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë tregon një shfrytëzueshmëri të qëndrueshme me 58%, mbi mesataren kombëtare.



Spitalet e Përgjithshme në Gjilani, Gjakova, Peja dhe Prizreni kanë shfrytëzueshmëri më të ulët, përkatësisht rreth 41%-42%, që sugjeron mundësi për optimizim të kapaciteteve ose nevoja për rritjen e kërkesës për shërbime spitalore në këto rajone.

2. Kohëzgjatja e Qëndrimit të Pacientëve (ALOS)

Mesatarja e përgjithshme e ALOS është 4.1 ditë. Spitali i Përgjithshëm në Pejë ka kohëzgjatjen më të lartë të qëndrimit (4.69 ditë), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj ka kohëzgjatjen më të ulët (3.6 ditë). Kjo tregon se pacientët në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë kanë nevojë për trajtim më të gjatë, ndërsa pacientët në Ferizaj përfundojnë trajtimin më shpejt.

3. Vizita Ambulatore

Totali i vizitave ambulatore është 1,100,205. Spitali i Përgjithshëm në Prizren ka numrin më të lartë të vizitave (297,684), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri ka numrin më të ulët (54,817). Kjo tregon për një realizim më të lartë për shërbimet ambulatore në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren dhe një realizim më të ulët në Spitalin e Përgjithshëm në Vushtrri.

4. Numri i Operacioneve

Totali i operacioneve është 18,129. Spitali i Përgjithshëm në Prizren ka numrin më të lartë të operacioneve (4,719), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri ka numrin më të ulët (1173). Kjo tregon për një aktivitet më të lartë kirurgjikal në Prizren dhe një aktivitet shumë më të ulët në Spital të Përgjithshëm në Vushtrri.

5. Lindjet

Totali i lindjeve është 9 505, me 3 587 prej tyre të kryera me ndërhyrje CS (38%). Spitali i Përgjithshëm në Prizreni ka numrin më të lartë të lindjeve (2382), ndërsa Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri ka numrin më të ulët (111).

4.2. Cilësia e Shërbimeve

1. Numri i Vdekjeve dhe Përqindja e Vdekjeve

- ❖ Totali i vdekjeve është 1,497, që përfaqëson 2% të numrit të pacientëve të shtrirë. Sp i Prizrenit ka numrin më të lartë të vdekjeve (408), ndërsa Vushtrria ka numrin më të ulët (36). Përqindja më e lartë e vdekjeve është në Pejë (3%), ndërsa përqindja më e ulët është në Vushtrri (1%).

2. Numri i Ditët e Shërimit

- ❖ Totali i ditëve të shërimit është 314,259. Prizreni ka numrin më të lartë të ditëve të shërimit (72,685), ndërsa Vushtrria ka numrin më të ulët (12,935). Kjo tregon për një përkushtim më të madh ndaj trajtimit të pacientëve në Prizren dhe një angazhim më të vogël në Vushtrri.

Spitali	Ditët e Shërimit	Numri i Shtretërve	Nr i pacienteve të shtrirë
Gjilan	49,384	325	11,015
Mitrovicë	39,814	233	10,301
Pejë	60,858	388	12,975
Vushtrri	12,935	63	3,235
Prizren	72,685	470	19,274
Gjakovë	63,176	426	14,966
Ferizaj	15,407	62	4,257

Spitali i Prizrenit ka numrin më të madh të pacientëve të shtrirë mesatarisht në ditë (52.8), duke treguar një ngarkesë më të lartë krahasuar me spitalet e tjera.

Gjakova dhe Peja gjithashtu trajtojnë një numër të konsiderueshëm pacientësh çdo ditë (41.0 dhe 35.5 respektivisht), çka tregon për kapacitet të mirë shërbimi.

Gjilani dhe Mitrovica kanë një numër të ngjashëm pacientësh të shtrirë në baza ditore (30.2 dhe 28.2), duke treguar një ngarkesë mesatare.

Ferizaj dhe Vushtrria kanë numrin më të ulët të pacientëve të shtrirë në ditë (11.7 dhe 8.9), që mund të nënkuptojë kapacitete më të vogla ose më pak kërkesë për shërbime të hospitalizimit.



1. Përqindja e lindjeve me CS (lindje cezariane): mesatarja e përgjithshme 38%

- ❖ **Peja (48%)** ka përqindjen më të lartë të lindjeve me CS, Sp i Gjilanit ka 42% të lindjeve të realizuara me CS, Spitali i Prizrenit ka 41% të lindjeve me CS.
- ❖ **Ferizaj (20%)** ka përqindjen më të ulët, duke sugjeruar përparësi për lindjet natyrale.

2. Numri i parametrave laboratorik:

- **Prizreni dhe Peja** ofrojnë një numër shumë të lartë analizash laboratorike, që tregon për qasje diagnostikuese të avancuar.
- **Mitrovica dhe Vushtrria** kanë shifra më të ulëta, duke treguar potencial për përmirësim.

3. Shërbime diagnostikuese:

CT (Tomografi e Kompjuterizuar) gjithsej 25,937

- Përdorim me një mesatare ditore prej 71 skanime në të gjitha njësitë spitalore. Spitali i Pejës e ka numrin më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi

Mamografi gjithsej 3,949

- Shfrytëzimi më i lartë në Pejë dhe Gjilan, me një mesatare prej 10.8 skanime në ditë në të gjitha njësitë spitalore.

MRI (4127) dhe RTG (116 200)

- MRI ka përdorim të përqendruar në Pejë, me një mesatare prej 11.9 skanime ditore (220 ditë pune).
- RTG përdoret gjerësisht në të gjitha spitalet, me një mesatare prej 318.3 skanime ditore (365 ditë), me Spitalin e Prizrenit dhe Pejës që kanë një përdorim më të lartë krahasuar me spitalet tjera.



4.3. Shërbimet e ofruara sipas Spitaleve të Përgjithshme

Spitali i Përgjithshëm në Prizren

INDIKATORI	GJITHSEJ (VJETOR)	MESATARE MUJORE
BOR (SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRETËVE)	42%	42%
ALOS (QËNDRIMI NË SPITAL)	3.8 ditë	3.8 ditë
VIZITA AMBULANTORE	297,684	24,807
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	4,271	356
ULTRAZË	20,828	1,736
EKG	13,795	844
ELEKTRONEUROMIOGRAFI (EMNG)	184	15
ELECTROENCEFALOGRAFI (EEG)	265	22
OPERACIONE	4,719	393
RENTEGEN (RTG)	24,159	2,013
REZONANCA MAGNETIKE (MRI)	1,505	125
LABORATOR (PARAMETRA LABORATORIK)	654,229	54,519
EKOKARDIOGRAFI	1,626	136
STRESS TEST (TREDMIL)	190	16
HOLTER KARDIAK	227	19
LINDJET	2,382	198
NUMRI I LINDJEVE	2,416	201
LINDJET ME CS	968	81
DIALIZA	30,172	2,514
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	19,274	1,606
DITËT E SHËRIMIT	72,685	6,057
KORONAROGRAFI	311	26
STENT	120	10

- BOR (Shfrytëzueshmëria e Shtretërve) – 42%**
 - ❖ Ky tregues tregon se shtretërit janë shfrytëzuar në një nivel mesatar.
- ALOS (Qëndrimi Mesatar në Spital) – 3.8 ditë**
 - ❖ Qëndrimi mesatar prej 3.8 ditësh.
- Numri i Pacientëve të Shtirë dhe Ditët e Shërimit**
 - ❖ Mesatarisht, çdo muaj shtrihen 1,606 pacientë dhe kalohen 6,057 ditë të shërimit.
- Shërbimet Diagnostike dhe Laboratorike**
 - ❖ Mesatarisht ofrohen mbi 54,000 parametra laboratorike çdo muaj, duke treguar një kapacitet të lartë të laboratorit.
 - ❖ CT (356/muaj), MRI (125/muaj) dhe Rentgeni (2,013/muaj).
- Intervenimet Mjekësore**
 - ❖ Mesatarisht kryhen 393 operacione në muaj.
 - ❖ Dializa me 2,514 raste mujore tregon një numër të lartë pacientësh që varen nga ky shërbim jetik.
- Lindjet dhe Lindjet me Operacion (CS)**



- ❖ Mesatarisht ndodhin 201 lindje në muaj, prej të cilave 81 janë me prerje cezariene, një përqindje relativisht e lartë.

7. Shërbimet e Kardiologjisë

- ❖ Kryhen mesatarisht 136 ekokardiografi, 26 koronagrafi dhe 10 vendosje stentesh çdo muaj.

Reparti	Nr. Shtretërve	Ditët e mjekimit	Të shtrirë	Vizita ambulatore	Nr. i pac.të operuar	Nr i vdekjeve	Gjatësia e shërimit	Shfrytëzim i kapaciteteve %
Gjinekologji	21	3110	1238	7767	160		2.5	40.6
Obstetrik	46	6714	2775	7141	968		2.4	40
Pediatri	48	9854	2127	14880		1	4.6	56.2
Neonatalogji	43	4071	2420	1987		2	1.7	25.9
Kirurgji	32	4845	1815	7018	1480	4	2.6	41.5
Ortopedi	20	4740	779	9588	542	6	6.1	64.9
Urologji	18	2853	698	6106	539		4.1	43.4
Oftalmologji	16	1659	305	12021	254		5.4	28.4
ORL	22	2092	912	12701	727		2.3	26.1
Infektiva	33	4783	1181	4306		1	4	39.7
Neurologji	20	3206	495	4264		92	6.5	43.9
Psikiatri	20	2107	238	6028		2	8.9	28.9
Pulmologjia	45	5811	670	8236		36	8.7	35.3
Interno	50	11923	2024	11363		109	5.7	60
Interno	18	3243	699			63	4.5	71.2
Nj.Koronare								
Emergjenca				41403				
Hemodializa				30172				
Kardiologjia Invazive	5	651	303				2.1	71.3
Dhomat e zgjimit rep.Kirurgji	8	873	335			92	2.6	29.9
Maxilla	6	150	150	1407	49		1	
Gjithsej	471	72685	19164	186388	4719	408	3.8	42.6

1. Kapaciteti dhe Shfrytëzimi i Shtretërve

- Numri total i shtretërve: 471
- Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve: 42.6%
- Departamentet me shfrytëzim më të lartë të kapaciteteve:
 - ❖ Njësia Koronare (71.2%)
 - ❖ Kardiologjia Invasive (71.3%)
 - ❖ Interno (60%)
 - ❖ Ortopedia (64.9%)
 - Njësitë që trajtojnë sëmundje kardiovaskulare dhe ortopedike kanë përqindjet



më të larta të shfrytëzimit të kapaciteteve, duke treguar një ngarkesë të lartë pacientësh në këto reparte.

2. Gjatësia mesatare e shërimit

- Mesatarja për të gjitha repartet: 3.8 ditë
- Repartet me shtrirje më të gjatë të pacientëve:
 - ❖ Pulmologjia (8.7 ditë)
 - ❖ Neurologjia (6.5 ditë)
 - ❖ Ortopedia (6.1 ditë)
 - ❖ Interno (5.7 ditë)

➤ Shërbimet që kanë pacientë me patologji kronike (pulmologjia, neurologjia, interno) kanë qëndrime më të gjata në spital, duke sugjeruar nevojën për më shumë resurse ose kapacitete shtesë në këto njësi.

3. Numri i pacientëve të operuar

- Numri total i operacioneve: 4,719
- Reparti me numrin më të lartë të operacioneve: Kirurgjia (1,480 operacione)

4. Numri i vdekjeve

- Numri total i vdekjeve në vit: 408
- Shkalla e vdekshmërisë mesatare: 2.1%
- Departamentet me numrin më të lartë të vdekjeve:
 - ❖ Interno (109 vdekje)
 - ❖ Neurologjia (92 vdekje)
 - ❖ Pulmologjia (36 vdekje)
 - ❖ Njësia Koronare (63 vdekje)

➤ Shumica e vdekjeve ndodhin në repartet që trajtojnë sëmundje të zemrës, mushkërive dhe neurologjike.

5. Vizitat Ambulatore

- Numri total i vizitave ambulatorë: 186,388
- Departamentet me numrin më të lartë të vizitave:
 - ❖ Emergjenca (41,403 vizita)
 - ❖ Oftalmologjia (12,021 vizita)
 - ❖ ORL (12,701 vizita)
 - ❖ Interno (11,363 vizita).



Blloku kirurgjik: Reparti i Kirurgjisë

1. Operacionet më të shpeshta sipas diagnozës

- ❖ **Apendiciti akut (K35) – 304 raste**, duke qenë diagnoza më e zakonshme kirurgjikale.
- ❖ **Hernia inguinale (K40) – 265 raste**, një nga ndërhyrjet më të zakonshme për hernie.
- ❖ **Koletiaza (guret në tëmth) - K80 – 285 raste**, ndërhyrje e shpeshtë për gurët në fshikëzën biliare.
- ❖ **Kolecistiti (infeksioni i fshikëzës së tëmthit) - K81 – 161 raste**.
- ❖ **Cista pilonidale (L05) – 69 raste**, trajtohet zakonisht për shkak të abscesit në zonën sakrokoksigeale.

2. Procedurat kirurgjikale dhe trajtimet postoperative

- ❖ **Kirurgji vizita – 7,018 raste**, duke reflektuar konsultimet kirurgjikale të nevojshme.
- ❖ **Tualet dhe fashime – 2,671 raste**, një procedurë e rëndësishme për menaxhimin e plagëve postoperative.
- ❖ **Hegja e pejeve – 957 raste**, duke treguar një volum të madh ndërhyrjesh me sutura.
- ❖ **Incizione – 658 raste**, zakonisht për absceset ose dekompresimin kirurgjikal.
- ❖ **Eho abdominale – 1,664 raste**, një mjet diagnostikues për të monitoruar pacientët postoperativë.
- ❖ **Operacionet me laparoskop – 413 raste**, një metodë minimale invazive e përdorur për ndërhyrje të ndryshme.

Reparti i Ortopedisë

Diagnostikat dhe Ndërhyrjet më të Shpeshta

- **Frakturat janë diagnoza dominuese në repartin e ortopedisë, me ndërhyrje të shumta për:**
 - ❖ **Fraktura e femurit (S72.0 – 37 raste)**
 - ❖ **Fraktura e qafës së femurit (S72.0 – 53 raste)**
 - ❖ **Fraktura e trupit të femurit (S72.3 – 32 raste)**
 - ❖ **Fraktura e boshtit të tibiae (S82.2 – 11 raste)**
 - ❖ **Fraktura e patellës (S82.0 – 11 raste)**

Frakturat e gjymtyrëve të poshtme (femuri, tibia) përbëjnë shumicën e rasteve kirurgjikale, duke reflektuar një incidencë të lartë të traumave.

- **Sëmundjet degjenerative të kyçeve janë gjithashtu të shpeshta, veçanërisht:**
 - ❖ **Gonartroza (M17) – 25 raste**
 - ❖ **Shtrembërimi i tunelit karpal (G56.0) – 23 raste**
 - ❖ **Ganglionet (M67.4) – 5 raste**



Reparti i Urologjisë

Diagnozat më të shpeshta

- ❖ **Hernia inguinale (K40) – 160 raste**, është ndër patologjitë më të zakonshme që kërkojnë ndërhyrje kirurgjikale.
- ❖ **Venat varikoze dhe varikocela (I86, I86.1) – 83 raste**, duke reflektuar prevalencën e sëmundjeve vaskulare urologjike.
- ❖ **Neoplazma malinje e fshikëzës urinare (C67) – 51 raste**, që tregon një incidencë të lartë të kancerit urologjik.
- ❖ **Gurët në traktin urinar (N20, N21) – 87 raste**, që është një nga problemet më të zakonshme të pacientëve në urologji.
- ❖ **Hiperplazioni i prostatës (N40) – 90 raste**, një diagnozë e zakonshme të meshkujt e moshuar.

Reparti i ORL-se

1. Diagnozat më të shpeshta

- ❖ **Sëmundjet kronike të bajameve dhe adenoideve (J35)** janë diagnoza më e shpeshtë me **354 raste** gjatë vitit.
- ❖ **Devijimi i septit nazal (J34.2)** është regjistruar **78 herë**, një nga ndërhyrjet më të zakonshme në ORL.
- ❖ **Polipet nazale (J33)** janë regjistruar në **25 raste**, ndërkohë që absceset dhe infeksionet e lëkurës kanë qenë më të rralla.
- ❖ **Neoplazmat beninje të lëkurës dhe indit dhjamor (D17, D21, D23)** janë ndër diagnozat më të shpeshta me **87 raste në total**.

Reparti i Oftalmologjisë

Diagnozat më të shpeshta

- ❖ **Katarakta senile (H25)** është diagnoza më e shpeshtë, me **170 raste** gjatë vitit, duke përfaqësuar një problem të zakonshëm tek pacientët e moshuar.
- ❖ **Trupi i huaj në sy (T15)** është identifikuar në **178 raste**, një nga problemet më të zakonshme emergjente të syrit.
- ❖ **Dislokimi i lensit (H27.1)** ka pasur **36 raste**, një patologji më e rrallë, por që kërkon ndërhyrje të specializuara.
- ❖ **Plaga e hapur e kapakut të syrit (S01.1)** është raportuar në **9 raste**, ndërsa **kontuzioni i kokërdhokut të syrit (S05.1)** ka ndodhur vetëm një herë.



Njesia e Anestezionit

Procedurat më të realizuara

- ❖ **Monitorimi i pacientëve** është procedura më e realizuar, me **4116 raste** gjatë vitit. Kjo tregon një përkujdesje të vazhdueshme për pacientët gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimeve intensive.
- ❖ **Anestezioni i përgjithshëm endotrakeal** ka qenë metoda më e përdorur, me **3128 raste**, që përfaqëson pjesën më të madhe të ndërhyrjeve që kërkojnë anestezi totale.
- ❖ **Anestezioni intravenoz** është kryer **537 herë**, duke qenë metoda e dytë më e zakonshme për sedacionin e pacientëve.
- ❖ **Vizitat preanesteziologjike dhe vlerësimi i riskut** janë realizuar **1166 herë**, duke siguruar përgatitje adekuate për pacientët para ndërhyrjeve kirurgjikale.

Repertet e Mjekësisë së Brendshme (Interno)

1. Shërbimet më të realizuara

- ❖ **Vizitat internistike**, me **10,265 vizita** gjatë vitit.
- ❖ **Elektrokardiografia (EKG)** është kryer **6,643 herë**.
- ❖ **Eho kardiologjike** është kryer **1,626 herë**.

2. Procedurat diagnostike gastroenterologjike

- ❖ **Gastroskopia** është realizuar **588 herë**, një numër relativisht i moderuar për një ekzaminim kaq të rëndësishëm.
- ❖ **Kolonoskopia** është kryer **283 herë**.

3. Procedurat më pak të realizuara ose të paofruara

- ❖ **Ergometria (Testi i Stresit)** është realizuar vetëm **190 herë**, një numër i ulët duke marrë parasysh rëndësinë e këtij testi për vlerësimin e sëmundjeve të zemrës.
- ❖ **Holter Kardiak** është realizuar **227 herë**, një numër relativisht i ulët për një ekzaminim që mund të ofrojë vlerësime të rëndësishme mbi ritmin kardiak dhe aritmitë.

Spitali i Përgjithshëm në Pejë

Më poshtë është tabela përmbledhëse me mesataret mujore për **12 muajt** për Spitalin e Pejës:

INDIKATORI	GJITHSEJ (12-MUJORI)	MESATARE MUJORE
SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRETËRVE (BOR)	43%	43%
KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT (ALOS)	4.6 ditë	4.6 ditë
VIZITA AMBULANTORE	191,082	15,923
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	5,939	494.92
ULTRAZË	28,240	2,353.33
EKG	16,109	1,342.42
ELECTROENCEFALOGRAFIA (EEG)	104	8.67
OPERACIONE	3,024	252
RENTGEN NATIV (RTG)	26,662	2,221
REZONANCA MAGNETIKE (MRI)	2,622	218.5
EKOKARDIOGRAFI	2,391	199.25
STRESS TEST	930	77.5
LINDJET	1,412	117.67
LINDJET ME CS	661	55.08
DIALIZA	13,190	1,099.17
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	12,975	1,081.25
DITËT E SHËRIMIT	60,858	5,071.5
MAMOGRAFIA	1,089	90.75

1. Efikasiteti i Shfrytëzimit të Resurseve

- Shfrytëzueshmëria e shtretërve (BOR) është **43%**,
- Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit (ALOS) është **4.6 ditë**.

2. Aktiviteti Ambulator dhe Diagnostikimi

- Vizitat ambulatorë janë në nivel të lartë, me **15,923 vizita mujore**.
- Tomografia e Kompjuterizuar (CT) ka një mesatare prej **495 ekzaminimesh mujore**.
- Rezonanca Magnetike (MRI) është përdorur **218 herë në muaj**.
- Ultrazëri dhe Rentgeni me mesatare mujore **2,353** dhe **2,222** ekzaminime përkatësisht.

3. Procedurat Kirurgjikale dhe Shërbimet e Specializuara

- Operacionet janë realizuar me një mesatare prej **252 ndërhyrjesh në muaj**.
- Lindjet janë në mesatare **118 lindje mujore**, me një përqindje të lartë të lindjeve cezariene (**55 në muaj, ose rreth 47% e totalit**).
- Dializa me **1,099 trajtime mujore**,
- Electroencefalografia (EEG) ka një mesatare prej vetëm **8.7 ekzaminimesh mujore**.



- **Stress Testi (Tredmil) dhe Holter kardiak** kanë gjithashtu një përdorim të kufizuar, duke sugjeruar një nevojë për rritjen e referimeve për këto shërbime.

Spitali i Pejës

Reparti	Nr. Shtreterve	Ditët e mjekimit	Të shtrirë	Vizita ambulantore	Nr. i pac.të operuar	Nr i vdekjeve	Gjatësia e shërimit	Shfrytëzim i kapaciteteve
Gjinekologji	28	4133	901	2934	58	0	4.59	41.7
Obstetrik	33	3899	1464	0	664	0	2.66	32
Pediatri	16	2681	733	21211	0	0	3.66	45.9
Neonatologji	20	3325	1395	1085	0	0	2.38	45.5
Kirurgji	35	6880	1583	6924	1293	0	4.35	53.9
Ortopedi	29	3529	631	6229	473	1	5.59	33.3
Urologji	19	3533	639	2484	257	6	5.53	50.9
Oftalmologji	11	1517	156	2507	43	0	9.72	39.9
ORL	18	1771	323	8067	236	0	5.48	27
Infektiva	14	2100	253	1295	0	1	8.30	41.1
Neurologji	24	2701	452	3228	0	51	5.98	30.8
Psikiatri	18	3121	188	2670	0	0	16.60	47.5
Pulmologjia	28	3018	469	2933	0	18	6.43	29.5
Interno	42	13605	1989	5582	0	162	6.84	88.7
Nj.Koronare	14	3873	1219	0	0	35	3.18	75.8
Emergjencia	7	0	0	56132	0	29		
Hemodializa	25	0	0	13190	0	0		0
Dhoma e zgjimit	7	1172	580	0	0	50	2.02	45.9
Gjithsej	388	60858	12975	136471	3024	353	4.6	43

1. Efikasiteti i Përdorimit të Kapaciteteve Spitalore

- ❖ **Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve spitalore është 43%**, duke treguar një nënshfrytëzim të shtretërve në shumicën e reparteve.
- ❖ **Departamenti më i shfrytëzuar është Interno (88.7%)**, i cili ka edhe numrin më të lartë të pacientëve të shtrirë (**1,989 pacientë**).
- ❖ **Departamenti më pak i shfrytëzuar është ORL (27%) dhe Pulmologjia (29.5%)**, që tregon se këto reparte kanë kapacitete të pashfrytëzuara në mënyrë efektive.

2. Kohëzgjatja Mesatare e Qëndrimit (ALOS - Average Length of Stay)

- ❖ **Mesatarja për spitalin është 4.6 ditë**, me variacione të mëdha mes reparteve.
- ❖ **Psikiatria ka kohën më të gjatë të qëndrimit me 16.6 ditë**, që është normale për trajtimet psikiatrike afatgjata.
- ❖ **Oftalmologjia ka kohëzgjatjen më të lartë për repartet kirurgjikale (9.72 ditë)**.

3. Vdekshmëria dhe Rastet e Ndërlikuara

- ❖ **353 vdekje janë raportuar në total**, ku **Interno ka numrin më të lartë (162 vdekje)**, e ndjekur nga **Kujdesi Intensiv (50 vdekje)** dhe **Neurologjia (51 vdekje)**.
- ❖ **Urologjia dhe Infektiva kanë nga një vdekje**, ndërsa shumica e reparteve të tjera nuk kanë raportuar raste fatale.



- ❖ **Ortopedia ka pasur 1 vdekje**, e cila mund të jetë për shkak të komplikimeve post-kirurgjikale.

4. Operacionet

Gjithsej janë kryer 3,024 operacione, me përqendrimin më të madh në:

- ❖ **Kirurgji (1,293 ndërhyrje)**, që përfaqëson 42.8% të të gjitha operacioneve.
- ❖ **Ortopedi (473 ndërhyrje)**, që është një numër i lartë, duke reflektuar një fluks konstant të pacientëve që kërkojnë ndërhyrje ortopedike.
- ❖ **Urologji (257 ndërhyrje)**, një shërbim shumë i kërkuar për problemet urologjike.
- ❖ **ORL (236 ndërhyrje)**, që tregon aktivitet të konsiderueshëm kirurgjikal në këtë repart.

5. Vizitat Ambulatore dhe specialistike

Numri i përgjithshëm i vizitave ambulantore dhe specialistike është 136,471, me përqendrimin më të lartë në:

- ❖ **Emergjencë (56,132 vizita)**, që tregon mbingarkesën e këtij shërbimi dhe nevojën për rritjen e burimeve.
- ❖ **Pediatria (21,211 vizita)**, duke reflektuar kërkesën e lartë për trajtim pediatrik.
- ❖ **ORL (8,067 vizita) dhe Kirurgjia (6,924 vizita)**, duke treguar ngarkesë të konsiderueshme në këto departamente.



Spitali i Përgjithshëm Gjakovë

INDIKATORI	GJITHSEJ (12-MUJORI)	MESATARJA MUJORE
SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRITËRVE (BOR)	41%	41%
KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT (ALOS)	4.2 ditë	4.2 ditë
VIZITA AMBULANTORE	99,206	8,267
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	4,144	345
ULTRAZË	15,989	1,332
EKG	15,004	1,250
ELECTROENCEFALOGRAFIA (EEG)	492	41
OPERACIONE	2,412	201
RENTGEN NATIV (RTG)	14,355	1,196
REZONANCA MAGNETIKE (MRI)	0	0
LABORATOR (PARAMETRA LABORATORIK)	524670	43722
EKOKARDIOGRAFI	898	75
STRESS TEST	0	0
HOLTER KARDIAK	0	0
ANGIOGRAFI	0	0
LINDJET	1,564	130
NUMRI I LINDJEVE	1,549	129
LINDJET ME CS	514	43
DIALIZA	9,641	803
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRITËRË	14,966	1,247
DITËT E SHËRIMIT	63,176	5,265

1. Shfrytëzueshmëria e Shtretërve (BOR) – 41 %

- ❖ Shfrytëzueshmëria e shtretërve është në nivel mesatar.

2. Kohezgjatja mesatare e qëndrimit në spital (ALOS) – 4.2 ditë

3. Numri i Pacientëve të Shtirë dhe Ditët e Shërimit

- ❖ Spitali trajton mesatarisht **1,247 pacientë të shtrirë në muaj**, me një total prej **5,265 ditë të shërimit**.

4. Shërbimet Diagnostike dhe Laboratorike

- ❖ Spitali ofron në muaj parametra laboratorike me **43722 teste laboratorike në muaj**.
- ❖ Ekzaminimet me **ultrazë (1,332/muaj)** dhe **rentgen (1,196/muaj)**.

5. Intervenimet Mjekësore

- ❖ Kryhen mesatarisht **201 operacione në muaj**.

6. Lindjet dhe Lindjet me CS (Prerje Cezariane)

- ❖ Mesatarisht ndodhin **130 lindje në muaj**, prej të cilave **43 janë me prerje cezariane** apo 20% rasteve.

7. Dializa

- ❖ Spitali ofron mesatarisht **803 shërbime të dializës në muaj**.

Indikatore të punës sipas reparteve



Reparti	Nr. Shtreterve	Ditët e mjekimit	Të shtrirë	Nr. i pac.të operuar	Nr i vdekjeve	Gjatësia e shërimit	Shfrytëzim i kapaciteteve
Gjinekologji	26	4102	1524	104		2.7	43.2
Obstetrik	31	8044	2082	514		3.9	71.1
Pediatri	56	7287	1711		5	4.3	35.7
Neonatologji	32	3809	1556		3	2.4	32.6
Kirurgji	46	7419	1735	1130	5	4.3	44.2
Ortopedi	24	2438	566	307		4.3	27.8
Urologji	22	2317	533	137		4.3	28.9
Oftalmologji	6	508	174	209		2.9	23.2
ORL	9	1348	272	11		5	41
Infektiva	21	715	257			2.8	9.3
Neurologji	24	3323	646		52	5.1	37.9
Psikiatri	26	4673	310			15.1	49.2
Pulmologjia	24	5444	643		26	8.5	62.1
Interno	48	7373	1553		102	4.7	42.1
Interno Nj.Koronare	13	2556	1013		18	2.5	53.9
Dermatovenerologjik	8	725	199			3.6	24.8
Dhoma e zgjimit. kirurgjisë	10	1095	192		43	5.7	30
Gjithsej	426	63176	14966	2412	254	4.2	40.6

Kapaciteti dhe Shfrytëzimi:

- Numri total i shtretërve në spital është **426**, me një shfrytëzim mesatar të kapaciteteve prej **40.6%**.
- Repartet me shfrytëzimin më të lartë të kapaciteteve janë **Neurologjia (51.1%)**, **Infektiva (51.1%)**, dhe **Psikiatria (49.2%)**, ndërsa repartet me shfrytëzim më të ulët janë **Dermatovenerologjia (24.8%)** dhe **Kujdesi intensiv i kirurgjisë (30%)**.

Numri i pacientëve të shtrirë dhe ditët e qëndrimit:

- Numri total i pacientëve të shtrirë është **14,966**.
- Ditët totale të qëndrimit në spital janë **63,176**, duke dhënë një mesatare prej **4.2 ditësh për pacient**.
- Kujdesi intensiv i kirurgjisë ka kohëzgjatjen më të lartë të qëndrimit (**5.7 ditë**), i ndjekur nga **Psikiatria (15.1 ditë)** dhe **Neurologjia (5.1 ditë)**.

Ndërhyrjet kirurgjikale:

- Numri total i pacientëve të operuar është **2,412**.
- Kirurgjia ka kryer më shumë operacione (1,130 ndërhyrje), ndjekur nga Obstetrika (514).



- Numri më i lartë i rioperimeve është në repartin e **Internos** (102 rioperime), që mund të tregojë komplikime post-operatore.

Numri i vdekjeve:

- Në total, janë regjistruar **254 vdekje**.
- Numri më i lartë i vdekjeve është regjistruar në **Neurologji (52)**, **Interno (47)** dhe **Kujdesi intensiv kirurgjisë (43)**.

Repartet me ngarkesën më të lartë:

- **Kirurgjia** ka numrin më të lartë të operacioneve.
- **Neurologjia** dhe **Interno** kanë numrin më të lartë të vdekjeve.
- **Psikiatria** ka kohëzgjatjen më të lartë të qëndrimit mesatar.
- **Infektiva dhe Neurologjia** kanë nivelin më të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve.

Spitali i Përgjthshëm Gjilan

Tabela e përmbledhur e indikatorëve kyc të performancës spitalore:

INDIKATORI	GJITHSEJ (12-MUJORI)	MESATARJA MUJORE
SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRETËRVE (BOR)	42%	42%
KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT (ALOS)	4.5 ditë	4.5 ditë
VIZITA AMBULANTORE	149,504	12,459
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	3,917	326
MAMOGRAFI	1,043	87
ULTRAZË	24,302	2,025
EKG	35,553	2,963
ELECTROENCEFALOGRAFIA (EEG)	196	16
OPERACIONE	2,059	172
RENTEGEN NATIV (RTG)	16,837	1,403
LABORATOR (PARAMETRA LABORATORIK)	210,136	17,511
EKOKARDIOGRAFI	1,636	136
LINDJET	1,288	107
LINDJET ME CS	535	45
DIALIZA	6,560	547
NUMRI I PACIENTËVE TË SHTRIRË	11,015	918
DITËT E SHËRIMIT	49,384	4,115

1. **Shfrytëzueshmëria e Shtretërve (BOR) – 42%**
2. **Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në spital (ALOS) – 4.5 ditë**
3. **Numri i Pacientëve të Shtirë dhe Ditët e Shërimit**
 - ❖ Spitali trajton mesatarisht **918 pacientë të shtrirë në muaj**, me një total prej **4,115 ditë të shërimit**.



4. Shërbimet Diagnostike dhe Laboratorike

- ❖ 17,511 parametra laboratorike në muaj.
- ❖ Ekzaminimet me ultrazë (2,025/muaj), CT (326/muaj) dhe mamografi (87/muaj).

5. Intervenimet Mjekësore

- ❖ Kryhen mesatarisht 172 operacione në muaj.
- ❖ Rentgeni me 1,403 ekzaminime në muaj.

6. Lindjet dhe Lindjet me CS (Prerje Cezariane)

- ❖ Mesatarisht ndodhin 107 lindje në muaj, prej të cilave 45 janë me prerje cezariane, një përqindje prej 42%.

7. Dializa

- ❖ Spitali trajton mesatarisht 547 shërbime për dializë në muaj.

Reparti	Nr. Shtreterve	Ditët e mjekimit	Të shtrirë	Vizita ambulantore	Nr. i pac.të operuar	Nr i rioperimeve	Nr i vdekjeve	Gjatësia e shërimit	Shfrytëzim i kapaciteteve
Gjinekologji	20	2405	756	8310	35	2	0	3.18	32.9
Obstetrik	16	3544	1361	0	536		0	2.60	60.7
Pediatri	28	2149	780	13338			0	2.76	21.0
Neonatologji	19	2533	1326	2829			0	1.91	36.5
Kirurgji	27	2125	854	7494	724	0	4	2.49	21.6
Ortopedi	19	3252	442	11524	308	2	12	7.36	46.9
Urologji	17	1300	257	3018	68	0	0	5.06	21.0
Oftalmologji	0	0	0	4786	0	0	0		
ORL	15	3980	701	8074	383	0	1	5.68	72.7
Infektiva	25	3009	628	1834			5	4.79	33.0
Neurologji	11	2022	302	4615			62	6.70	50.4
Psikiatri	15	1688	165	5607			0	10.23	30.8
Pulmologjia	26	5749	636	6842			42	9.04	60.6
Interno	62	11507	2099	9061			91	5.48	50.8
Interno Nj.Koronare	12	3519	707	4349			29	4.98	80.3
Dhoma e zgjimit	13	602	1				0		12.7
Gjithsej	325	49384	11015	91681	2054	4	246	4.48	41.6

1. Kapaciteti dhe Shfrytëzimi

- Numri total i shtretërve: 325
- Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve: 41.6%
- Repartet me shfrytëzimin më të lartë të kapaciteteve:
 - ❖ Interno Nj. Koronare (80.3%)
 - ❖ Neurologjia (72.7%)
 - ❖ Obstetrika (60.7%)
- Repartet me shfrytëzimin më të ulët të kapaciteteve:
 - ❖ Kirurgjia (21.6%)
 - ❖ Kujdesi Intensiv (12.7%)



2. Numri i Pacientëve dhe Ditët e Shtrimit

- ❖ Numri total i pacientëve të shtrirë: 13,015
- ❖ Ditët totale të mjekimit: 49,384
- ❖ Mesatarja e qëndrimit të pacientëve në spital: 4.48 ditë
- ❖ Repartet me qëndrimin më të gjatë të pacientëve:
 - Psikiatria (10.13 ditë)
 - Ortopedia (7.36 ditë)
 - Neurologjia (5.68 ditë)

3. Aktiviteti Kirurgjikal dhe Vizitat Ambulatorike

- ❖ Numri total i pacientëve të operuar: 2,054
- ❖ Numri i rioperimeve: 4
- ❖ Reparti me më shumë operacione: Kirurgjia (724 operacione)
- ❖ Numri i vizitave ambulatorë: 91,681
- ❖ Reparti me më shumë vizita ambulatorë: Pediatria (13,338 vizita)

4. Numri i Vdekjeve

- ❖ Numri total i vdekjeve: 246
- ❖ Repartet me numrin më të lartë të vdekjeve:
 - Interno (96 vdekje)
 - Neurologjia (29 vdekje)
 - Ortopedia (12 vdekje)

Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë

Tabela e përmbledhur e indikatorëve kyç të performancës spitalore:

Këtu është tabela përmbledhëse me mesataret mujore për **12 muajt** për Spitalin e Mitrovicës:

INDIKATORI	GJITHSEJ (12-MUJORI)	MESATARJA MUJORE
SHFRYTËZUESHMËRIA E SHTRETËRVE (BOR)	58%	58%
KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT (ALOS)	3.8 ditë	3.8 ditë
VIZITA AMBULATORE	217,663	18,139
TOMOGRAFI E KOMPJUTERIZUAR (CT)	3,253	271
ULTRAZË (NUMRI TOTAL)	6,185	515
EKG (NUMRI TOTAL)	6,246	520
EEG (ELEKTROENCEFALOGRAFIA)	227	19
OPERACIONE (NUMRI TOTAL)	2,871	239
RENTGEN NATIV (RTG)	15,560	1,297
LABORATOR (PARAMETRA LABORATORIK)	128,188	10,682
EKOKARDIOGRAFI	3,160	263
STRES TEST	327	27
HOLTER KARDIAK	134	11
LINDJE (NUMRI TOTAL)	1,598	133
LINDJE ME CS	635	53
DIALIZA	12,056	1,005
PACIENTË TË SHTRIRË	10,301	858
DITËT E SHËRIMIT	39,814	3,318
MAMOGRAFIA	544	45

- Shfrytëzueshmëria e Shtretërve (BOR) – 58%**
- Kohezgjatja mesatare e qëndrimit në spital (ALOS) – 3.8 ditë**
- Numri i Pacientëve të Shtirë dhe Ditët e Shërimit**
 - ❖ Spitali trajton mesatarisht **858 pacientë të shtrirë në muaj**, me një total prej **3,318 ditë të shërimit**.
- Shërbimet Diagnostike dhe Laboratorike**
 - ❖ Spitali ofron **10,682 parametra laboratorike** në muaj mesatarisht.
 - ❖ Ekzaminimet me **ultrazë (515/muaj)**, **CT (271/muaj)** dhe **mamografi (45/muaj)**.
- Intervenimet Mjekësore**
 - ❖ Kryhen mesatarisht **239 operacione në muaj**.
 - ❖ Rentgeni është ndër shërbimet më të përdorura me **1,297 ekzaminime në muaj**.
- Lindjet dhe Lindjet me CS (Prerje Cezariene)**
 - ❖ Mesatarisht ndodhin **133 lindje në muaj**, prej të cilave **53 janë me prerje cezariene**, një përqindje prej 40%.
- Dializa**
 - ❖ Spitali ofron mesatarisht **1,005 shërbime të dializës për pacient**.



Reparti	Nr. Shtreterve	Ditët e mjekimit	Të shtrirë	Vizita ambulatorore	Nr. i pac.të operuar	Nr i vdekjeve	Mjekimi mesatar	Shfrytëzim i kapaciteteve
Gjinekologji	15	5067	1108	5082	103		4.57	93%
Obstetrik	23	5639	1518	0	635		3.71	67%
Pediatri	25	4811	1168	36407			3.9	53%
Neonatologji	3	2342	1584	0			1.48	43%
Kirurgji	14	2638	771	11210	612	6	3.6	52%
Ortopedi	13	4208	655	13751	575		5.6	85%
Urologji	10	1775	444	11199	243		4	49%
Oftalmologji	12	1567	505	12203	428		3.2	37%
ORL	12	2193	271	10680	275		7.9	50%
Infektiva	6	590	90	1482		2	7.5	27%
Neurologji	12	2012	459	5318		38	5.5	46%
Psikiatri				1280				
Pulmologjia	10	2852	295	5811		19	9.1	75%
Interno	17	3156	905	10022		60	3.9	51%
Interno Nj.Koronare	8	817	218	5410		13	4.3	28%
Dhoma post operative intenzive	6	147	310					7%
